

MATERIAL MËSIMOR

Në mbështetje të mësuesve të profilit mësimor

KONTABILITETI I SIGURIMEVE

(Niveli III i KSHK)

NR. 11

Ky material mësimor i referohet:

- **Lëndës profesionale: “Kontabiliteti i sigurimeve”, kl.12 (L-17-369-19)**

E përgatitën

Anila Nanaj

Florie Begaj

Tiranë, 2020

Tema 1: Teknika e mbajtjes së kontabilitetit në sigurime

1.1 Legjislacioni për shërbimet në shoqëritë e sigurimeve

Siç e dimë detyrat e përgjithshme, parimet dhe rregullat kryesore për mbajtjen e kontabilitetit, që do të thotë përgatitja dhe paraqitja e informacioneve financiare rregullohen me ligj. Në varësi të specifikave të veprimtarisë zgjidhet forma e zbatimit të ligjit. Në shoqëritë e sigurime ky ligj rregullon krijimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit, me qëllim që tregu i sigurimeve të veprojë në një mjedis të sigurtë, të qëndrueshëm dhe transparent, në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të konsumatorit. Të gjitha këto rregullime realizohen duke iu referuar:

Ligjit Nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit“.

Ligjit Nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare“.

Ligji Nr.10110/2009“Për disa ndryshime në ligjin për kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare“.

Ligjit Nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar“ , neni 53.Sipas këtij ligji konsiderohen furnizime të përjashtuara nga TVSH –ja transaksionet e mëposhtme:

- shërbimet e sigurimit dhe të risigurimit ,përfshirë kryerjen e shërbimeve të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime nga agjentët dhe brokerat e sigurimit
- Ligjit Nr.9975 ,dt 28.07.2008“Për taksat kombëtare“, me ndryshimet e përditësuara.
- Taksat mbi primet e shkruara, me përjashtim të primeve të sigurimit për produktet e jetës, shëndetit në udhëtim dhe kartonit jeshil, është 10% e shumës së primit. Për pagesat e dëmeve që rrjedhin nga kontratat e sigurimeve nuk aplikohen taksa /tatime për faktin se nuk konsiderohen të ardhura.

Rregullave dhe udhëzimeve të AMF (Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare) për sigurimet. Këto ligje zbatohen nga personat fizikë dhe juridikë që ushtrojnë veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit, të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime, si dhe operacioneve që lidhen drejtpërsëdrejti me veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit në Republikën e Shqipërisë, AMF është autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre ligjeve.

1.2. Veçoritë e mbajtjes së kontabilitetit në shoqërinë e sigurimeve

Në shoqërinë e sigurimit dhe risigurimit, kontabiliteti duhet të organizohet dhe të mbahet sipas detyrimeve të përgjithshme e parimeve të përcaktuara në ligjin për kontabilitetin, duke përdorur metodën e regjistrimit të dyfishtë dhe parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Teknika e mbajtjes së llogarive mbështetet në Planin e Përgjithshëm Kontabël, duke reflektuar edhe veçoritë e veprimtarisë të sigurimit e të risigurimit. Shoqëria e sigurimit mban në mënyrë të vazhdueshme kontabilitetin, përgatit regjistrimet kontabël, vlerëson aktivet dhe detyrimet, përgatit pasqyrat financiare, mban dokumentacionin e veprimtarisë së sigurimit, si dhe të dhënat e tjera mbi administrimin ose veprimtarinë tregtare në një zyrë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në mënyrë që të mundësojë në çdo kohë kontrollin për kryerjen e veprimtarisë së sigurimit, në përputhje me rregullat e administrimit të rrezikut, legjislacionin në fuqi për metodologjitë e mbikëqyrjes dhe sipas rregullave të hartuara nga Autoriteti, e standardeve profesionale. Shoqëria e sigurimit duhet të garantojë që informacioni, dokumentacioni dhe të gjitha të dhënat , të jenë të sakta dhe të pasqyrojnë gjendjen e vërtetë financiare të shoqërisë. Shoqëritë e sigurimit i nënshtrohen zbatimit të SNRF (Standartit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar) 4 “Kontratat e sigurimit ,objektiv i të cilit është: të specifikojë raportimin financiar për kontratat e sigurimit nga çdo njësi ekonomike që lëshon kontrata të tilla (përshkruar në këtë SNRF si një sigures) derisa Bordi të plotësojë fazën e dytë

të projektit të tij mbi kontratat e sigurimit. Objektivi i pasqyrave financiare është që të japin informacion lidhur me:

- Pozicionin financiar të kompanisë;
- Performancën, dhe
- Ndryshimet në gjendjen financiare të një njësie ekonomike.

Kontabiliteti i çdo subjekti ekonomik është i mbështetur në standarde ndërkombëtare të kontabilitetit, të cilat janë bazë e një kontabiliteti të mirëfilltë dhe real. Kompanitë e sigurimeve kontabilitetin e bazojnë në standardet e kontabilitetit, por duke i përshtatur ato me rregullat, të cilat i kërkon mbikëqyrësi apo vetë kompania për nevojat e kompanisë. Deri në hartimin, miratimin e vënien në zbatim të planit kontabël specifik për veprimtaritë e sigurimit dhe risigurimit, kontabiliteti në shoqëritë e sigurimeve, bazohet në parimet e përgjithshme të kontabilitetit.

1.3.Përshkrimi i mbajtjes së kontabilitetit në shoqërinë e sigurimeve

Mbajtja e kontabilitetit në shoqërinë e sigurimeve bazohet në dokumenta justifikues të vlefshme për rregjistrimet kontabël dhe që mbartin të dhëna me vërtetësi për veprimin ose ngjarjen që kanë për objekt. Dimë që dokumenta kontabiliteti quhen të gjitha ato si mbartëse të të dhënave që integrohen në ciklin e trajtimit kontabël të informacionit. Dokumenti i përshkrimit të organizimit dhe i procedurave kontabël duhet të përgatitet dhe të përmbajë këto të dhëna:

- Organizimin e funksionit kontabël në ndërmarrje
- Planin e llogarive të ndërmarrjes dhe listën e ditarëve dhe librave që përdoren
- Sistemin dhe mjetet e përdorura
- Informatat kontabël që prodhohen (bilanc verifikues, balance mujore, tremujore ,etj)
- Klasifikimi dhe ruajtja e dokumentave kontabël

Referuar vendit që zënë këto dokumenta në ciklin kontabël dallohen:

- dokumenta justifikues fillestar (bazë) që mbështesin (justifikojnë) regjistrimet kontabël në librat e kontabilitetit
- libra të kontabilitetit si mbartës të regjistrimeve të kryera
- dokumenta të tjera

Dokumentat justifikues ndahen në:

- Dokumenta justifikues fillestarë (bazë)
- Dokumenta përmbledhës

Në bazë të këtyre dokumentave kryhet rregjistrimi i veprimeve sipas ligjit për kontabilitetin dhe më pas bëhet përmbledhja dhe grupimi i tyre në regjistrat kontabël. Këtu përmendim librin ditar, librin e madh, librin e inventarit, librin e shitjes, librin e blerjes, librin e pagave, etj

Shoqëria e sigurimit në bazë të dokumentave të regjistruara përgatit pasqyrat financiare dhe raporte të tjera të detajuara mbi veprimtarinë e saj, si dhe ia paraqet ato Autoritetit, në përputhje me formën, mënyrën, përmbajtjen, listën, periudhën, si dhe afatet kohore, të përcaktuara me rregullore nga Autoriteti. Ajo përgatit për çdo vit kalendarik pasqyrat financiare dhe raportet e tjera të paaudituar për veprimtarinë e saj dhe i paraqet në Autoritet brenda 31 marsit të vitit të ardhshëm.

1.4.Klasat e llogarive në shoqërinë e sigurimeve

Për pasqyrimin e veprimtarisë dhe kryerjen e regjistrimeve kontabël çdo njësi ekonomike duhet të përdorë një sërë llogarish. Për këtë ajo gjatë ciklit kontabël domosdoshmërisht harton planin

e llogarive. Duke qenë se numri i llogarive që përdoret në një njësi ekonomike është i madh dhe jo vetëm ,por nganjëherë ato kanë dhe emërtime të ngajshme, bëhet kodifikimi i llogarive.

- Lista e llogarive e paraqitur në planin kontabël përbën një kuadër ligjor nga i cili njësitë ekonomike mund të zgjedhin dhe të përdorin ato llogari që kanë të nevojshme por duke respektuar rregullat përkatëse. Veprimtaria e sigurimit ushtrohet në përputhje me klasat e mëposhtme:

A. Në përputhje me rreziqet, klasat e sigurimeve janë:

- Sigurimi i aksidenteve
- Sigurimi i sëmundjeve
- Sigurimi i mjeteve tokësore
- Sigurimi i mjeteve lëvizëse mbi shina
- Sigurimi i avionëve.
- Sigurimi i anijeve
- Sigurimi i mallrave në transport
- Sigurimi nga zjarri dhe forcat e natyrës
- Sigurimi i dëmtimeve të tjera të pasurisë
- Sigurimi i përgjegjësive civile nga përdorimi i automjeteve
- Sigurimi i përgjegjësive civile nga përdorimi i avionëve.
- Sigurimi i përgjegjësive civile për anijet
- Sigurimi i përgjegjësive civile të përgjithshme
- Sigurimi i kreditit
- Sigurimi i garancive
- Sigurimi i humbjeve të ndryshme financiare.
- Sigurimi i mbrojtjes ligjore.
- Sigurimi i asistencës
- Sigurim jete - vdekje
- Sigurim martese - lindje.
- Sigurim jete i lidhur me fonde të investimeve.
- Sigurimi i administrimit të fondeve kolektive
- Sigurimi i fondeve për pagesa.

Veprimtaria e sigurimit që mbulon më shumë se një klasë sigurimi klasifikohet në grupe sigurimi, të cilat janë ndërtuar si më poshtë:

1. Klasat e sigurimeve të aksidenteve dhe të sëmundjeve formojnë grupin që emërtohet: **Sigurimi i aksidenteve dhe i shëndetit.**
2. Klasat që kanë lidhje me sigurimin e mjeteve motorike tokësor, të përgjegjësive që ato shkaktajnë etj, formojnë grupin që emërtohet: **Sigurime motorike.**
3. Klasat që kanë lidhje me mallrat dhe mjetet e transportit po me lundrimin detar dhe ujor, formojnë grupin që emërtohet: **Sigurimi i marinës dhe i transportit.**
4. Klasa që kanë lidhje me transportin ajror formojnë grupin që emërtohet: **Sigurimi i avionëve.**
5. Klasat që kanë lidhje me zjarrin dhe incidentet e tjera, formojnë grupin që emërtohet: **Sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë.**
6. Klasat e sigurimeve të përgjegjësive në transport, në udhëtimin me avionë, me anije etj, formojnë grupin që emërtohet : **Sigurimi i përgjegjësive.**
7. Klasat e sigurimit të kreditit dhe të garancive formojnë grupin që emërtohet: **Sigurimi i kreditit dhe i garancisë.**
8. Klasat e sigurimit që kanë lidhje me jetën formojnë grupin që emërtohet: **Sigurimi i jetës.**

Në praktikën e sigurimeve veprimtaria e siguruesve ndahet dhe administrohet në dy ndarje të mëdha:

1. **Sigurimi jo-jetës** që mbulon gjithë klasat nga 1 -18,ose grupin 1-7
2. **Sigurimi i jetës** që mbulon klasat nga 19-23 ose grupin 8

Tema 2: Bilanci kontabël dhe struktura e ndërtimit të tij në ndërmarrjet e sigurimeve

2.1. Kuptimi dhe funksionimi i bilancit në shoqëritë e sigurimeve

Bilanci është një pasqyrë financiare në të cilën paraqiten të ndara në dy seksione dhe të grupuara pasuria e ndërmarrjes, çfarë ajo zotëron dhe çfarë ka marrë hua në një moment të caktuar. Nisur nga ky përkufizim le të shohim kuptimin dhe funksionimin e bilancit për shoqëritë e sigurimeve. Bilanci i një shoqërie sigurimi pasqyron gjendjen financiare të aktiveve dhe pasiveve që shoqëria ka, e thënë ndryshe ai shpreh pozicionin financiar që ka shoqëria e sigurimit në një çast të dhënë, d.m.th. pasqyrën që tregon:

- Se çfarë dhe sa të mira zotëron, nga të cilat realizohet ose pritet të realizohet një përfitim ekonomik;
- Kujt dhe sa i detyrohet shoqëria e sigurimit në një moment të dhënë (detyrimet që janë borxhet e firmës ndaj të tretëve), dhe
- Diferencën zotërime minus detyrime ndaj të tretëve që është detyrimi kapital ndaj themeluesve, pronarëve apo aksionarëve të shoqërisë së sigurimit.

Në pasqyrën e bilancit të shoqërisë së sigurimit ndodhen të grupuara elementë që lidhen drejtëpërdrejtë me vlerësimin e pasurisë dhe të gjëndjes financiare të saj.Llogaritë vjetore (bilanci kontabël) përshkruajnë efektet e veprimeve dhe ngjarjeve të tjera ,duke i grupuar këto në disa grupe të mëdha sipas karakteristikave të tyre ekonomike Këto llogari paraqiten në bilanc sepse janë elementë që lidhen drejtëpërdrejtë me vlerësimin e pasurisë dhe të gjëndjes financiare të ndërmarrjes dhe konkretisht në:

- Aktivet
- Pasivet
- Kapitali i vet

Pavarësisht emërimit të zërave të ndryshëm të llogarive që do të shohim në trajtimin e kontabilitetit për shoqërinë e sigurimeve, rregulli klasik i regjistrimeve kontabël është i njëjtë që do të thotë: Ana e majtë e bilancit (Aktivi) duhet të jetë e barabartë me anën e djathtë (pasivi + kapitali i vet).

2.2.Veçoritë e bilancit në shoqëritë e sigurimeve

Bilanci i një shoqërie sigurimi dallon nga bilancet e firmave të tjera në zërat përbërës të tij.Tri janë veçoritë dalluese dhe të rëndësishme në mënyrën sesi hartohet bilanci i shoqërive të sigurimeve:

- Veçoria e **parë** lidhet me kapitalin aksioner. Shoqëritë e sigurimit nuk mund të lejohen të fillojnë aktivitetin e tyre pa respektuar kushtin e një minimumi të domosdoshëm të kapitalit.Ky nivel minimum llogaritet në mënyrë të tillë që të mbulojë gjithë risqet nga siguruesi.
- Veçoria e **dytë** lidhet me nevojën e një aftësie paguese minimale.Aftësia paguese lidhet kryesisht me ata sigurues, që aktivitetin e tyre e kanë mbështetur te shitja e policave dhe grumbullimi i të ardhurave prej primeve nga njëra anë dhe te pagesa e dëmeve

policëmbajtëse nga ana tjetër .Aftësia minimale e një siguruesi duhet të jetë 200% në raport me detyrimet e siguruesit.Kjo vlerë do të thotë që zërat e aktivitetit të bilancit ,duhet të jenë në vlerën mbi 200% të detyrimeve.

- Veçoria e **tretë** qëndron në raportin optimal midis kapitalit dhe rezervave teknike.Ndër zërat kryesore të pasivitetit të bilancit janë rezervat dhe provizionet.Vlerat e rezervave dhe provizioneve nuk mund të tejkalojë disa herë kapitalin.

Forma dhe mënyra e prezantimit të pasqyrave financiare janë të njëjta për të gjithë subjektet , por brendia e zërave të tyre nuk e kanë të njëjtën peshë për të gjitha subjektet, si ato prodhuese tregtare apo shërbyese si dhe atyre subjekteve financiare.Duhet të dimë se : veprimtaria e shoqërive të sigurimeve është garantimi i një kompensimi të një humbje nga shuma e primeve të realizuara. Kjo do të thotë se nuk dihet se kur do të ndodhë dëmi, prandaj kërkohet që në çdo moment të kemi mjete të mjaftueshëm për kompensimin e dëmit. AMF, mjaftueshmërinë e mjeteve financiare të shoqëritë siguroese i rregullon me anë të ligjit, me qëllim mbrojtjen e konsumatorit.

2.3.Struktura e ndërtimit të bilancit në shoqëritë e sigurimeve

Bilanci duhet t'i shërbejë sa më mirë qëllimit për të cilin është hartuar dhe se kjo do të thotë që të dhënat në të duhet të jenë të ndara në dy seksione dhe të grupuara në mënyrë sa më të përshtatshme sipas karakteristikave të përbashkëta cilësore që ato kanë. Ekuacioni i bilancit kontabël të shoqëritë e sigurimeve është:

$$\text{Asetet} = \text{Detyrimet} + \text{teprica e mbajtjes së policave (kapitali)}$$

Bilanci i shoqërive të sigurimit do të ketë strukturën e mëposhtme:

N R	Aktivi	SH	N R	Pasivi + kapitali i vet	Sh
	A. Kapitali i nënshkruar i papaguar B. Aktive të patrupëzuara C. Investime D. Investime të kryera për policëmbajtësit e sigurimit të jetës që mbajnë rrezikun e investimit E. Pjesa e provigjonit teknik të risigurimit. F. Debitorë G. Aktive të tjera H. Parapagime dhe të ardhura të llogaritura I. Të tjera aktive			A. Kapitali dhe rezervat B. Detyrime të varura C. Provizionet teknike D. Provizionet teknike për policat e sigurimit ku rreziku i investimit buron nga policëmbajtësi E. Provizione për shpenzime dhe rrisqe të tjera F. Detyrimet që rrjedhin nga risiguruesi G. Kreditorë H. Të ardhura të marra dhe regjistruara avancë I. Pasive të tjera	
	TOTALI			TOTALI	

Për të kuptuar dhe interpretuar më mirë bilancin e shoqërive të sigurimeve,është e nevojshme shpjegimi dhe sqarimi i disa rubrikave të veçanta të pasivitetit të dhe të aktivitetit të bilancit.Në anën e djathtë të tij ,tërheqin vëmendjen disa rubrika që kanë lidhje me provizionet dhe që justifikojnë dhe mbështesin atë që konsiderohet si veçori e shoqërive të sigurimit. Në anën e majtë të bilancit dallohet pjesa e provizioneve që u përket risiguruesve.Duke qenë se për provizionet për primin e pafutuar, një pjesë duhet ta përballojë risiguruesi, përderisa policat apo ngjarjet janë të risiguruara ,siguruesit kanë të drejtë të presin dhe llogarisin pjesën e provizionit

për ta ndarë me risiguruesin.Kjo do të thotë se ata e kanë këtë një të drejtë,një mjet që e kontabilizon në llogaritë aktive të bilancit.

Për shembull:

Më poshtë do të paraqesim një model të thjeshtë, pa vlera, të bilancit kontabël të një shoqërie sigurimesh.

N R	Aktivi	SH	N R	Pasivi + kapitali i vet	Sh
	-Para në arkë dhe në bankë -Depozita bankare me afat -Investimet në letra me vlerë -Aktive të lidhura me risigurimin -Aktive të qëndrueshme të trupëzuara neto -Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara -Llogaritë e arkëtueshme nga sigurimet dhe risigurimet -Aktive të tjera			-Rezerva teknike për dëmet -Rezerva teknike për Primet e pafiturar -Të tjera detyrime Total detyrime -Kapitali themeltar -Rezervat e kapitalit -Humbje + fitimi i akumuluar -Humbje +fitimi i periudhës Total kapitali	
	TOTALI	XX		TOTALI	XX

Shoqëritë e sigurimit regjistrojnë dhe pasqyrojnë në mënyrë kronologjike kategoritë e veçanta të aktiveve, sipas grupeve bazë të sigurimeve dhe llojeve të policave brenda grupit.

2.4. Paraqitja e elementëve pasuror në bilanc (Aktivi)

Aktivi është seksioni i majtë i bilancit dhe në të grupohen tërësia e burimeve të kontrolluara në një moment të dhënë,që kanë ardhur nga veprime të kryera apo ngjarje të ndodhura dhe nga të cilat ndërmarrja pret përfitime ekonomike në të ardhmen.Që një element të jetë pjesë e aktivitetit duhet të plotësojë kushtet:

- Ndërmarrja duhet të ushtrojë mbi atë element të drejtën e pronësisë
- Të ketë aftësinë për të krijuar drejtëpërdrejtë ose tërthorazi prurje pozitive likuiditetesh apo ekuivalent likuiditetesh për ndërmarrjen

Ashtu sin ë kontabilitetin e ndërmarrjeve tregtare dhe në shoqëritë e sigurimit llogaritë aktive debitoohen për shtesat dhe kreditohen për pakësimet. Nisur nga destinacioni që kanë aktivet në ndërmarrje grupohen:

- Aktive të qëndrueshme qarkulluese
- Aktive qarkulluese

Aktivitet të qëndrueshme janë ato lloj aktivesh të cilat parashikohen të përdoren për disaperiudha ushtrimore dhe nga përdorimi i tyre priten të sigurohen fitime në këto periudha.

Grupi i aktiveve të qëndrueshme ndahet në:

- Aktive të qëndrueshme të trupëzuara (ndërtesa, makineri e pajisje, instalime teknike, etj)
- Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara janë elementë në formën e vlerave ose të drejtave pasurore nga të cilat shoqëria siguron përfitime në të ardhmen (patenta, liçensa, emri i mirë,etj)
- Aktive të qëndrueshme financiare

Aktive qarkulluese janë ato aktive të cilat për shkak të destinacionit të tyre ose natyrës nuk qëndrojnë gjatë në formën që kanë në ndërmarrje. Ripërtëritja e tyre brenda një viti ushtrimor është një nga tiparet themelore të tyre. Le të shohim se çfarë përfshihet në secilin grup të aktiveve.

Investimet. Në këtë grup regjistrohen të gjitha investimet sipas burimeve të financimit.

Toka dhe ndërtime. Në këtë grup regjistrohen pagesat e kryera për toka dhe ndërtime, si dhe parapagimet dhe pagesat pjesore të kryera për ndërtimet në proces. Këtu regjistrohen edhe të drejtat në pasuri të paluajtshme dhe të drejta të tjera të ngjashme të përcaktuara në Kodin Civil.

Aksione të lidhura me sipërmarrje (filiale jashtë territorit). Në këtë grup regjistrohen aksione të lidhura me sipërmarrje, me të cilat do të kuptojmë filiale, degë, apo zyra përfaqësimi të shoqërisë së sigurimit që ushtrojnë aktivitetin e tyre në emër dhe për llogari të shoqërisë vendase të sigurimit, por që aktivitetin e tyre e ushtrojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Interesa pjesëmarrëse. Në këtë grup regjistrohen të drejtat në kapitalin e sipërmarrjeve të tjera, të cilat kanë për qëllim të krijojnë qëndrueshmëri në to. Zotërimi i pjesës së kapitalit në një sipërmarrje tjetër presupozon një interes pjesëmarrës.

Aksione dhe pjesëmarrje të përbashkëta. Në këtë grup regjistrohen aksionet e një sipërmarrje që krijohet nga bashkimi i disa sipërmarrjeve ose fonde pensioni, drejtimi i së cilës i është besuar njërit nga sipërmarrësit ose fondit të pensioneve.

Depozita në institucione të tjera krediti. Në këtë grup regjistrohen shumat e depozituara në institucione të autorizuara, me afate të përcaktuara në marrëveshje.

Të tjera. Në këtë grup regjistrohen të gjitha investimet e tjera, që nuk janë përfshirë në zerat e mësipërm.

Depozita në shoqëritë çeduese. Në bilancin e një shoqërie që pranon risigurime, do të regjistrohen shumat që zotërohen nga shoqëria çeduese e sigurimit. Këto shuma i korrespondojnë garancive të depozituara në shoqëritë çeduese, ose pranë palëve të treta.

Pjesa e provizionit teknik të risiguruesit. Në këtë grup regjistrohen shumat aktuale ose të vlerësuara të provizionit teknik që shoqëria e risigurimit detyrohet të paguajë në rastet e ndodhjes së dëmeve, sipas marrëveshjes kontraktuale të risigurimit, të cilat janë përgjegjësi e risiguruesit. Kjo rubrikë e aktivitetit llogaritë e veçantë sipas llojit të provizionit teknik për primin e pafiturar, për sigurimin e jetës, për dëmet pezull, për bonuse e rabate, për provizione të tjera teknike, si dhe nga policat e sigurimit të jetës, kur rreziku i investimit buron nga policmbajtësit. Provizioni teknik i risigurimit përfaqësohet detyrimisht nga depozita ose garanci për shoqërinë e sigurimit.

Provizioni teknik për primet e pafiturara (pjesa e risiguruesit), do të llogaritë në përputhje me metodat e përcaktuara për llogaritjen e këtij provizioni ose në përputhje me kushtet e policës së sigurimit.

Debitorë që rrjedhin nga veprimtaria direkte e sigurimit. Në këtë grup futen policmbajtësit dhe ndërmjetësit.

Policmbajtësit ku përfshihen:

- policmbajtësit që detyrohen për këstet vijuese të kontratës, për të cilat ata kanë paguar të paktën një këst.
- Detyrime për dëmet e shkaktuara nga mbajtësit e mjeteve motorike të papajisur me çertifikatën e sigurimit.
- Detyrime të tjera të policmbajtësve; si dëme të paguara më tepër apo prime të arkëtuara më pak, etj.

Ndërmjetësit ku përfshihen:

- detyrimet e ndërmjetësve (agjentëve) për policat e sigurimit të shitura në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit, si dhe detyrimet e tjera që lindin nga marrëdhëniet e ndërmjetësimi në sigurime.

Debitorë që rrjedhin nga veprimtaria e risigurimit. Në këtë grup regjistrohen:

- Detyrime që rrjedhin nga shoqëritë ceduese (risiguruese) për kontratat e lidhura dhe ende të paarkëtuara, që përballohen nga risiguruesi si:
- Detyrimet e shoqërive risiguruese ndaj shoqërisë ceduese për pjesën e dëmeve, që sipas kontratave të lidhura përballohen nga shoqëritë risiguruese.
 - Shuma e primit, e vendosur në formën e depozitës për risiguruesit.
 - Të tjera detyrime që lindin nga marrëdhëniet midis shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, që nuk janë përfshirë në grupimet e mësipërme.

Debitorë të tjerë. Në këtë grup regjistrohen të gjithë debitorët e tjerë që nuk janë përfshirë në grupet e mësipërme, për të cilët evidentimi kontabël bëhet siç është përcaktuar në planin kontabël. Këtu regjistrohen shumat e qirasë të mbartura periodikisht dhe të llogaritura, por të paarkëtuara.

Aktive të tjera.

Aksione të veta. Në këtë grup regjistrohen vlerat nominale të aksioneve të veta **Shpenzime të marrjes në sigurim për sigurimin e jetës (të shtrira në vitet e ardhshme).** Në këtë grup regjistrohen shpenzime të marrjes në sigurim të jetës të shtrira në vitet e ardhshme në përputhje me kushtet e përcaktuara në rregulloren e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për llogaritjen e provizioneve teknike dhe matematike.

Parapagime të tjera. Në këtë grup regjistrohen shpenzime të tjera të kryera gjatë vitit financiar, por që lidhen me vitin ose vitet financiare në vijim, së bashku me çdo të ardhur tjetër, e cila megjithëse lidhet me vitin financiar aktual, pasqyrohet në këtë zë.

Llogaritë jashtë bilancit. Në këtë grup regjistrohen angazhime të të tretëve ndaj shoqërisë së sigurimit për dhënie me qira etj., sipas kontratës së lidhur për këtë qëllim. Këtu evidentohet vlera totale e qirasë (angazhimit) të përcaktuar për të gjithë periudhën e kontraktuar. Kjo vlerë pakësohet me arkëtimet e qirave (angazimit) të llogaritura.

1.5. Detyrimi dhe kapitali i vet në shoqëritë e sigurimeve

Detyrimet

Ana e djathtë e bilancit quhet Pasivi dhe kapitali i vet ose siç e njohim ndryshe Detyrimet dhe kapitali i vet. Dimë që pasivet përfaqësojnë detyrimet e shoqërisë në një datë të dhënë ndaj të tretëve. Që një element të jetë pjesë e detyrimeve duhet të plotësojë kushtin që detyrimi të ketë lindur, dmth të ketë marrë formën juridike të zbatimit, si rrjedhojë e një kontrate që ka forcën e ligjit ose si rrjedhojë e një detyrimi të drejtëpërdrejtë ligjor (p.sh detyrimet tatimore).

Detyrimet paraqiten në bilanc në varësi të natyrës apo prejardhjes së tyre. Gjithashtu për të vlerësuar gjendjen financiare të shoqërisë ato paraqiten të grupuara në varësi të afatit të mbetur për shlyerjen e tyre. Në këtë rast grupet janë:

- Detyrime afatshkurtra (me afat shlyerje brenda një viti)
- Detyrime afatgjata (me afat shlyerje më shumë se një vit)

Edhe në shoqëritë e sigurimit, llogaritë e detyrime funksionojnë njëlloj si llogaritë e ndërmarrjeve tregtare, që do të thotë debitohen për pakësimet dhe kreditohen për shtesat.

Konkretisht:

Llogaria “Furniturë” kreditohet për shumën e faturave që lidhen me blerjen e materialeve si dhe me shërbimet e kryera nga të tretët për ndërmarrjen të cilat janë të destinuara për veprimtarinë e shfrytëimit të saj.

Llogaria “Furnitorë për aktive të qëndrueshme” kreditohet për shumën e faturave për blerjen e aktiveve të qëndrueshme duke debituar llogarinë “Aktive të qëndrueshme”, dhe kështu me rradhë të gjitha llogaritë e detyrimeve.

Kapitali i vet

Kapitali i vet përfaqëson financime të brendshme ose të drejta të mbetura si diferencë e aktiveve të shoqërisë pas zbritjes së detyrimeve të saj. Në një shoqëri aksionere siç janë shoqëritë e sigurimit kapitali i vet ndahet në :

- Fondet e sjella nga aksionerët (kapitali themeltar)
- Fitimet e pashpërndara
- Llojet e rezervave që përfaqësojnë fitimet neto të ruajtura nga shoqëria.

Në shoqëritë e sigurimeve krijimi i rezervave në shumicën e rasteve është i parashikuar në ligj ose në statutin e shoqërisë me qëllim që t'i japë asaj dhe kreditorëve të saj mbrojtje kundër efektit të humbjes. Këtu përfshihen rezervat e sigurisë ose rezervat për të arritur fondin e garancisë, si dhe rezerva të tjera. Kapitali themeltar si pjesë e kapitalit të vet përfaqëson vlerën nominale të aksioneve në të cilat është ndarë kapitali i shoqërisë. Kapitali në shoqëritë e sigurimit është i përbërë nga kapitali bazë dhe kapitali shtesë. I shohim me radhë se çfarë përfaqëson njëri grup dhe çfarë grupi tjetër.

Kapitali bazë

Në llogaritjen e kapitalit bazë të shoqërisë së sigurimit futen elementët:

- Kapitali aksioner i shoqërisë së sigurimit, i cili përbëhet nga aksionet e zakonshme të emetuara;
- Rezerva e kapitalit, të cilat nuk i korrespondojnë detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e sigurimeve;
- Fitimi i pashpërndarë, i mbartur pas zbritjes së dividendëve të pagueshëm

Kapitali shtesë

Në llogaritjen e kapitalit shtesë të shoqërisë së sigurimit futen elementët:

- Kapitali aksioner i shoqërisë së sigurimit, i cili përbëhet nga aksionet me përparësi të akumuluar;
- Instrumente të borxhit të varur;
- Rezerva kapitali që lidhen me aksionet me përparësi të akumuluar;
- Elemente të tjera.

Në shoqëritë e sigurimeve kapitali përbën edhe fondin e garancisë të shoqërisë së sigurimit. Ky fond garancie është i përbërë nga kapitali bazë dhe kapitali shtesë. Sipas legjisllacionit përkatës nuk duhet të jetë më pak se 1/3 e kufirit minimal të aftësisë paguese.

Le të shohim sipas grupeve përbërjen e pasivit në sigurime

Detyrime të varura. Në këtë grup regjistrohen detyrimet sipas një marrëveshje kontraktuale, që në rastin e mbylljes ose falimentimit të një shoqërie sigurimi, përgjegjësitë që burojnë nga kjo marrëveshje do të paguajnë dëmet e të gjithë kreditorëve të tjerë.

Provizione për primin e pafituar dhe rrezikun e paskaduar. Në këtë grup regjistrohen provizionet për primin e pafituar, si nga shoqëritë që ushtrojnë aktivitetin e jetës dhe ato që ushtrojnë aktivitetin e jojetës. Shuma e këtij provizioni i korrespondon pjesës së primit të shkruar që i përket periudhës së rrezikut pas datës së mbylljes së vitit financiar. Provizioni për rrezikun e paskaduar është material, ai duhet të pasqyrohet i veçantë si në bilanc, ashtu edhe në shënimet e bilancit.

Provizione për sigurimin e jetës. Në këtë grup regjistrohen provizionet e sigurimit të jetës, të cilat përfshijnë vlerën aktuariale të përgjegjëseve të një shoqërie sigurimi, përfshirë bonuset gjithashtu të deklaruar dhe pas pakësimit të vlerës aktuariale të primit të ardhshëm.

Provizione për dëmet pezull. Në këtë grup regjistrohen provizionet për dëmet, si nga shoqëritë që ushtrojnë aktivitetin e jetës dhe ato të jojetës. Këtu përfshihen: Provizionet për dëmet pezull

të ndodhura dhe të raportuara në vitin financiar aktual, por ende të papaguara brenda vitit financiar; të ndodhura në vitin financiar, por të paraportuara në këtë periudhë.

Provizione për bonuset dhe rabatet.Në këtë grup regjistrohen provizionet për bonuse dhe rabate që përfaqësojnë shumat e parashikuara për policmbajtësit ose përfituesit, të llogaritura në përputhje me kontratat e sigurimeve.

Provizione barazimi.Në këtë grup regjistrohen provizione të llogaritura në mënyrë të tillë që shoqëria të përmbushë në çdo kohë, çdo detyrim të lindur nga kontratat e sigurimeve për aq sa parashikon vetë shoqëria e sigurimit.

Provizione teknike për policat e sigurimit të jetës kur rrisku i investimit buron nga policmbajtësi. Në këtë grup regjistrohen vetëm provizionet teknike të krijuara për mbulimin e përgjegjësive që lidhen me investimet, vlera ose kthimi i të cilave është përcaktuar në përputhje me investimet për të cilat policmbajtësi mban rriskun.

Provizione për shpenzime dhe rrisqe të tjera

Provizione për pensione dhe përgjegjësi të ngjashme. Në këtë grup regjistrohen provizionet (rezervat) për shpenzime dhe rrisqe që synojnë mbulimin e humbjeve dhe detyrimeve të një natyre krejtësisht të përcaktuar të cilën në datën e mbylljes së bilancit, janë të sigurta për të ndodhur, por të pasigurta për datën në të cilën ato do të ndodhin.

Provizione për taksa.Në këtë grup regjistrohen provizionet për shpenzime dhe rrisqe që synojnë mbulimin e humbjeve nga origjina të tjera të vitit financiar, të një natyre krejtësisht të përcaktuar, pas shikimit ose parashikimit të vitit financiar, por të cilat në datën e mbylljes së bilancit janë të sigurta për të ndodhur, por të pasigurta për datën në të cilën do të ndodhin.

Të tjera provizione .Këtu regjistrohen provizione të tjera të cilat nuk janë përfshirë në dy grupet e mësipërme.

Detyrime të tjera që rrjedhin nga risiguruesit.Në këtë grup regjistrohen vlerat e depozituara nga ose të mbajtura nga shoqëria e sigurimit sipas një kontrate risigurimi. Këto vlera nuk do të bashkohen me vlera të tjera që zotërohen nga shoqëri të tjera në fjalë.

Kreditorë që rrjedhin direkt nga veprimtaria siguruese.Në këtë grup regjistrohen detyrimet e shoqërisë ndaj të siguruarve si:

Shuma të vetë policmbajtësve, ku regjistrohen shumat:

- që sipas kontratave të sigurimit shoqëria u detyrohet për kthimin e primeve;
- detyrime të shoqërisë ndaj të siguruarve për dëmet e ndodhura të rëna dakord për t'u paguar dhe të llogaritura, por akoma të palikuiduara;
- detyrime të shoqërisë së sigurimit ndaj mbajtësve të policave të sigurimit të jetës për të cilat është marrë përsipër rreziku i investimeve (interesi që përfitojnë klientët).

Të tjerë kreditorë që rrjedhin nga veprimtaria direkte e sigurimeve ku regjistrohen:

- Detyrimet ndaj ndërmjetësve në sigurime për komisionet e ndërmjetësimit.
- Detyrimet ndaj ndërmjetësve për dëmet që këta të fundit kanë paguar për llogari të shoqërisë së sigurimit dhe/ose risigurimit, si dhe
- të tjera detyrime që rrjedhin nga shitja e policave.

Kreditorë që rrjedhin direkt nga veprimtaria risiguruese. Në këtë grup regjistrohen detyrimet e shoqërisë ndaj shoqërive të risigurimit për likuidimin e primit, sipas kontratës së risigurimit, detyrime të shoqërive ceduese ndaj shoqërive risiguruese për likuidimin e primit sipas kontratës, detyrime ndaj shoqërive ceduese për pjesën e dëmeve që duhet të paguhet sipas kontratës së risigurimit, detyrime të shoqërive risiguruese ndaj shoqërive ceduese për pjesën e dëmeve që duhet të paguajë sipas kontratës, detyrime për retrocensionet, si dhe detyrimet e tjera që lindin në veprimtarinë e risigurimit.

Hua të varura, të veçanta nga ato të kthyeshme.Në këtë grup regjistrohen shumat që shoqëritë e sigurimit detyrohen të paguajnë në vijim të kontratës së sigurimeve.

Kreditorë të tjerë përfshirë edhe taksat dhe sigurimet shoqërore. Në këtë grup trajtimi kontabël bëhet siç është përcaktuar në Planin Kontabël të Përgjithshëm. Këtu regjistrohen detyrimet e qiramarrësve për llogaritjen e qirasë së maturuar periodikisht, por ende të paarkëtuar, e cila pakësohet me arkëtimet në periudhën pasardhëse.

Të ardhura të marra dhe të regjistruara në avancë. Në këtë grup regjistrohen të ardhura të marra para datës së mbylljes së bilancit financiar, por këto të ardhura janë të lidhura me vitin financiar dhe që së bashku me ndonjë shpenzim tjetër do të paguhet në vitin financiar në vijim.

Llogari jashtë bilancit. Në këtë grup regjistrohen angazhime të shoqërisë së sigurimit ndaj të tretëve, për marrjen me qira etj., sipas kontratës së lidhur për këtë qëllim.

1.6. Provizionet dhe interesat në pjesëmarrjen në shoqëritë e sigurimeve

Një **provizion** është një pasiv i pasigurtë në kohë dhe në shumë. Një pasiv është një detyrim aktual i një njësie ekonomike që rrjedh nga ngjarje të shkuara, shlyerja e të cilit pritet të rezultojë me një dalje nga njësia ekonomike të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike. Njësitë ekonomike e njohin provizionin si një detyrim në pasqyrën financiare dhe shumën e tij si një shpenzim, referuar përkufizimit në bazë të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit. Një provizion do të njihet në rastin kur mundësia për realizimin e tij është më e madhe se mosrealizimi i tij. Në rastin e kundërt kur mundësia e realizimit është më e vogël se mosrealizimi i tij, atëherë provizioni nuk do të njihet. Gjatë periudhës kontabël krijimi i një provizioni të ri, apo rritja e një provizioni ekzistues rregjistrohet si shpenzim. Shuma e njohur si provizion do të jetë vlerësimi më i saktë i shpenzimeve të kërkuar për të shlyer detyrimin aktual në datën e mbylljes së bilancit. Vlerësimi më i mirë i shpenzimit të kërkuar për të shlyer detyrimin aktual është shuma që një shoqëri sigurimesh do të paguajë në mënyrë të arsyeshme për të shlyer detyrimin në datën e bilancit ose për ta transferuar atë tek një palë e tretë në atë kohë. Shoqëritë e sigurimit i rishikojnë provizionet në çdo datë të raportimit dhe i rregullojnë ato për të pasqyruar vlerësimin më të mirë aktual të shumës që do të kërkohej për të shlyer detyrimin në atë datë të raportimit. Çdo rregullim i shumave të njohura më parë do të njihet në humbje ose në fitim. Shoqëria e sigurimit krijon dhe mban gjatë gjithë veprimtarisë së saj provigjone teknike të mjaftueshme për të mbuluar në kohë përgjegjësitë e nënshkruara dhe humbjet nga rreziqet, që rrjedhin nga kontratat e sigurimit. Provizionet teknike llogariten bruto, pa zbritur risigurimet e ceduara, në përputhje me parimet aktuariale dhe rregullat e miratuara nga Autoriteti. Shoqëria e sigurimit krijon llojet e mëposhtme të provigjoneve teknike:

- provigjone për prime, të cilat përbëhen nga provigjonet për primet e pafituara dhe për rreziqe të paskaduara;
- provizione për bonuse dhe rabate;
- provizione teknike të dëmeve;
- ç) provizione për mbrojtjen për rrezikun ndaj investimit;
- provizione teknike të tjera

Interesat në pjesëmarrje në shoqëritë e sigurimeve kanë një vlerë dhe peshë të rëndësishme në aktivitetin e shoqërisë. Këto interesa kanë lidhje me politikën e investimit të këtyre shoqërive. Politikën e investimit, hartohen, miratohen dhe zbatohen me qëllim shmangien e rrezikut të tepërt të humbjes dhe arritjen e një kthimi të arsyeshëm nga investimi. Interesa pjesëmarrëse (ose investimet në shoqëri të bashkëkontrolluara). Në këtë zë do të përfshihen ato investime në njësitë ekonomike në të cilat shoqëria mëmë zotëron influencë domethënëse (dhe e cila nuk është as filial/ shoqëri e kontrolluar dhe as një interes kapitali në një sipërmarrje të përbashkët) por jo kontroll mbi aktivitetin e kësaj njësie ekonomike; zakonisht shoqërohet me zotërim të aksioneve në masën 20-50%. Zotërimi i aksioneve në këtë masë me të drejtë vote përbën pjesëmarrje të cilësuar. Për vlerësimin kontabël të investimeve me interesa pjesëmarrëse

do të përdoret metoda e kapitalit neto. Metoda e kapitalit neto është metodë e kontabilitetit sipas të cilës investimi njihet fillimisht me kosto dhe rregullohet më pas për ndryshimin pas blerjes të pjesës që i përket investorit në aktivet neto të të investuarit. Fitimi ose humbja e investitorit përfshin pjesën që i takon atij në fitimin ose humbjen e të investuarit. Gjithashtu zbatohen kërkesat e standarteve përkatëse për të përcaktuar nëse ndonjë humbje zhvlerësimi shtesë duhet të njihet në lidhje me interesin e investitorit në pjesëmarrje. E gjithë vlera kontabël e investimit testohet për zhvlerësim.

2.7 Kontabilizimi i provizioneve, të kërkesave të blera dhe kërkesave në proces të shoqërive të sigurimit

Shoqëria e sigurimit mund të krijojë provizione për rreziqe të paskaduara. Provizionet për primet e pafituara dhe provizionet për rreziqet e paskaduara përbëjnë së bashku provizionet për primet e pafituara. Aktuari është personi që ka si detyrë kryesore llogaritjen e tarifave të primeve, tabelave të probabilitetit, provizioneve duke u mbështetur në teori shkencore që lidhen me investimet, statistikën, matematikën, financën dhe demografinë. “Provizion teknik” është shuma e llogaritur në bazë të një parashikimi dhe sipas mënyrave aktuariale të caktuara, e cila mbahet nga siguruesi për të mbuluar përgjegjësitë që rrjedhin nga kontratat e sigurimit. “Provizion teknik bruto” është shuma totale e provizioneve teknike që përbëhet nga provizionet teknike të llogaritura nga siguruesi dhe provizionet teknike për rreziqet e mbuluara nga risigurimi.

“Provizion matematik” është shuma e llogaritur në bazë të një parashikimi dhe sipas metodave të caktuara aktuariale, e cila mbahet nga siguruesi për të mbuluar përgjegjësitë që rrjedhin vetëm nga kontratat e sigurimit të jetës.

- **Provizionet - Shumat kontabël të parashikuara si rezerva** - është një shumë e ruajtur për detyrim që njihet ose që mund të parashikohet në mënyrë të arsyeshme, për ngjarje që mund të ndodhin
- **Primet dhe rezervat e primit të pafituar**
 - **primi neto:** primi i shkruar-primi i komp.risigurimit
 - **primi neto**= primi neto i fituar + prim neto i pafituar
- Primi neto i pafituar quhet *Rezerve e Primit të pafituar*

Për shembull, një prim për një vit më datën 1 Tetor 2017 do të ishte 3/12 i fituar në vitin 2017 dhe 9/12 do të ishte një rezervë primi e pafituar në fund të vitit. Kjo 9/12 do të fitohej në vitin 2018. Primi i fituar është i barabartë me:

- primet e shkruar (neto-ja e risigurimit dhe një fond për kostot e shpërndarjes dhe fikse), +
- rezervën e primit të pafituar në fillim të periudhës, -
 - primin e pafituar në fund të periudhës. **Pra** (a) + (b) - (c)

Krijimi i shumave të parashikuara (provizionet) në kontabilitet do të regjistroheshin duke **debituar** llogaritë e shpenzimeve me nëndarjet përkatëse dhe duke **kredituar** llogaritë e provizioneve në pasiv të bilancit. Duhet të theksohet se në kontabilitet është e rëndësishme të konstatohen dy flukes:

- lindja e një detyrimi që ka sjellë një shenzim për periudhën ushtrimore të dhënë
- anulimi i shumës së parashikuar që e ka plotësuar objektivin e saj dhe që sjell një të ardhur.

Tema3: Struktura e të ardhurave dhe shpenzimeve në ndërmarrjet e sigurimeve

3.1. Koncepti i të ardhurave në shoqëritë e sigurimeve

Dimë që të ardhurat janë shumat që realizon ndërmarrja nga shitja e mallrave, produkteve ose shërbimeve që ajo prodhon ose tregton. Ato përfaqësojnë përfitimet ekonomike bruto, të marra gjatë periudhës kontabël, si rezultat i rrjedhës normale të veprimtarisë së njësisë ekonomike raportuese, atëherë kur këto përfitime ekonomike çojnë në rritjen e kapitalit (këtu nuk përfshihen rritjet, që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital). Burimi kryesor i të ardhurave të një njësie ekonomike është shitja e mallrave dhe kryerja e shërbimeve. Burime të tjera mund të jenë interesi, dividendët, komisionet, etj. Të ardhurat janë shtim i aktiveve të ndërmarrjes që realizohen gjatë vitit ushtrimor ose gjatë realizimit të shpenzimeve. Burimi kryesor i rezultatit të veprimtarisë së sigurimeve është e ardhura nga primet bruto të shkruara. Nocioni “të ardhurat bruto nga primet e shkruara” ka kuptimin e të ardhurave nga kontratat e lidhura. Për shoqëritë e sigurimeve konsiderohet e ardhur shumta e primit të faturuar. E shohim me një shembull: Nëse primi bruto i shkruar është 1000 euro atëherë shoqëria e sigurimit konsideron të ardhur shumën 1000 euro. Të ardhurat i studiojmë të ndara në dy grupe:

- të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit - ku bëjnë pjesë të ardhurat e siguruar nga ushtrmi i veprimtarisë së shoqërisë : shitja e produkteve të sigurimit, nga kryerja e punimeve e shërbimeve, nga qeratë, honoraret, komisionet, etj.
- të ardhura të tjera dhe plusvlera - në të cilat zakonisht bëjnë pjesë të ardhurat e siguruar jashtë veprimtarisë së shoqërisë si: shitja e aktiveve të qëndrueshme, nga shtimi i aktiveve si rezultat i dhurimeve, subvencioneve, etj.

3.2 .Llojet e të ardhurave në shoqëritë e sigurimeve

Të ardhurat e realizuara nga shoqëritë e sigurimit, sikurse nga çdo njësi ekonomike janë të shumëllojshme. Me qëllim studimin, evidentimin dhe interpretimin e tyre, ato klasifikohen në disa grupe. Klasifikimi kontabël i të ardhurave, dhe mbi këtë bazë caktimi i llogarive për regjistrimin e tyre bëhet në funksion të natyrës së tyre dhe duke u bazuar në ligjin “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Të ardhurat klasifikohen në:

- të ardhura nga primet,
- të ardhura nga investimet, dhe
- të ardhura të tjera të shoqërisë.

Të ardhurat nga primet përbëhen nga primet e sigurimit bruto të korigjuara me primet e paguara për risigurime, me ndryshimin e provizioneve (rezervave) për primet bruto në ndryshimet në provizionet (rezervat) e primit të risigurimit.

Të ardhurat nga investimet paraqiten të analizuara sipas kategorisë së investimeve, si:

- të ardhurat nga letra me vlerë,
- nga aksione dhe pjesëmarrje të tjera me afat të gjatë zotërimi,
- nga kredi hipotekare,
- nga pasuri të paluejtshme,
- nga interesa dhe
- nga të tjera investime.

Të ardhura të tjera të shoqërisë - përfshihet çdo lloj tjetër e ardhure dytësore, që nuk bën pjesë në dy grupet e para, trajtimi kontabël i të cilave realizohet ashtu siç është përcaktuar në Planin Kontabël të Përgjithshëm. Siç e përmendëm dhe në mësimin e kaluar burimi kryesor i të ardhurave për shoqëritë e sigurimit është e ardhura nga primet bruto të shkruara. Të ardhurat nga primet e paguara për risigurim janë shumta e primeve që siguresit kanë grumbulluar nga

klientët e tyre, por që janë të destinuar për të siguruar veten (risigurimin). Pra kjo është një zbritje nga primet bruto dhe jo një shpenzim për risigurim (prime të çeduar). Të ardhurat nga ndryshimi në provizion të primeve të pafituara bruto ka kuptimin e nocionit kontabël të rimarrjeve nga provizionet. Në kontabilitetin e sigurimeve luhet me tepriçën e llogarisë së provizioneve. Kjo do të thotë nëse llogaria e provizioneve të primit të pafituar e një vit të mëparshëm, ka një nivel më të lartë krahasuar me nevojat e vitit vijues, atëherë kemi të bëjmë me një të ardhur. Nëse provizioni i ri është më i ulët se provizioni i vjetër (që do të thotë se nëse provizioni i vitit vijues është më i ulët se provizioni i krijuar i një viti më parë), atëherë për diferencë kemi të bëjmë me një të ardhur. Por, provizioni për primin e pafituar mund të rezultojë me shenjë minus. Të ardhurat nga ndryshimi në provizion të primeve të pafituara pjesë e risiguresve, është shuma që përfiton risiguresisi pjesë të vetën, në rastin kur aktuarët vlerësojnë se provizionet e lidhura me primet e vitit në vijim mund të rriten ose të zvogëlohen. Prandaj pjesa e risiguresit mund të plus, minus (+/-).

3.3. Koncepti i shpenzimeve në shoqëritë e sigurimeve

Për të realizuar veprimtarinë e saj shoqëria e sigurimeve duhet të realizojë shpenzime duke përdorur pasurinë e saj për të siguruar të ardhura. E thënë ndryshe shpenzimet janë kostot e të mirave të shitura nga ndërmarrja ose të shërbimeve të kryera prej saj gjatë procesit të realizimit të të ardhurave. Shpenzimet përfaqësojnë konsumin ose përdorimin e pasurisë për të prodhuar produkte apo kryer shërbime ose për të ushtruar veprimtari të tjera. I njëjti arsyeim logjik funksionon edhe për shoqëritë e sigurimeve. Në shoqëritë e sigurimeve shpenzimet grupohen në:

- shpenzime nga aktiviteti i shfrytëzimit
- humbje dhe minusvlera

Për vetë natyrën e aktivitetit që kanë shpenzimet do të dallonim:

- shpenzime për dëmet,
- shpenzimet për parandalimin e dëmeve,
- shpenzime për arkëtimin e primit,
- bonuset dhe skontimet,
- shpenzimet operative,
- shpenzime për investime dhe
- shpenzime të tjera të sigurimeve.

Shpenzimet për dëmet klasifikohen sipas grupeve të sigurimit duke paraqitur shumën bruto dhe shumën e risigurimeve. Shpenzimet për dëmet përfshijnë vlerën e kompensimit për dëmin e ndodhur dhe shpenzimet e trajtimit të dëmit. Vlera e kompensimit për dëmin e ndodhur është shuma që përfitojnë personat e siguruar në rastin e ndodhjes së dëmit. Në shpenzimet e trajtimit të dëmit përfshihen shpenzimet e brendshme ose të jashtme, që lidhen me trajtimin e rastit të sigurimit, llogaritjen e vlerës së dëmit, shpenzimet gjyqësore dhe shpenzimet për ekspertë. Shpenzimet operative që kryhen nga shoqëritë e sigurimit klasifikohen në shpenzime për shitjen e policave të sigurimit (marrjes në sigurim) dhe shpenzime të tjera operative ku përfshihet:

- amortizimi i aktiveve të qëndrueshme,
- shpenzime personeli,
- shpenzime materiale,
- shërbime nga të tretët, etj.

Shpenzimet për shitjen e policave të sigurimit (marrjes në sigurim) përbëhen nga:

- shpenzimet për përgatitjen e policës,
- për komisionet e ndërmjetësimit,

- për publikime,
- përgatitjen e ofertave për çmimin dhe
- shpenzimet për lëshimin e policës:

3.4.Llogaritë teknike dhe jo teknike të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve

Llogaria teknike, Jojetë

Llogaria teknike (rezultati financiar nga aktiviteti i drejtpërdrejtë i sigurimit/risigurimit) për aktivitetin e sigurimit raportohet e veçantë për sigurimin e jetës dhe sigurimin e jojetës (dëmeve).

Llogaria teknike për shoqëritë që ushtrojnë veprimtari në klasat e sigurimit të jo-jetës është e ndarë sipas klasave të sigurimit. Bilanci jep rezultatin për secilin portofol gjatë vitit financiar. Të dhënat e pasqyruara në Llogarinë Teknike duhet të ndahen sipas klasave dhe grupimeve të mëposhtme:

1. Sigurimi i aksidenteve dhe e shëndetit;
2. Sigurime motorike detajuar sipas produkteve të sigurimit: ‘Kasko’, ‘MTPL e brendshme,’ ‘Karton Jeshil’, dhe ‘Kufitare’;
3. Sigurimi i anijeve, përfshirë Sigurimi i përgjegjësive për anijet;
4. Sigurimi i avionëve, Sigurimi i përgjegjësive nga përdorimi i avionëve;
5. Sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë;
6. Sigurimi i mallrave në transport pavarësisht nga mënyra e transportit;
7. Sigurimi i përgjegjësive;
8. Sigurimi i kreditit;
9. Sigurimi i garancive;
10. Sigurimi i mjeteve lëvizëse mbi shina;
11. Sigurimi i humbjeve të ndryshme financiare;

Rezultati teknik i sigurimeve është diferencë midis të ardhurave nga primet teknike dhe shpenzimeve për dëmet, të shtuara ose të pakësuara nga rritja ose pakësimi i provigjoneve teknike të sigurimit për periudhën. Të ardhurat dhe shpenzimet nga investimi të lidhura me klasat e sigurimit të jo-jetës nuk do të përfshihen në llogarinë teknike të sigurimeve jo-jetë por do të pasqyrohen vetëm në llogarinë ‘Fitim humbje’. Të ardhurat dhe shpenzimet nga investimi të lidhura me klasat e sigurimit të jetës do të përfshihen në llogarinë teknike të sigurimeve Jetë dhe do të shpërndahen midis klasave të sigurimit të jetës. Kjo mënyrë shpërndarjeje do të jetë pjesë e shënimeve të pasqyrave financiare. Në rastin e një shoqërie që ushtron veprimtari sigurimi si për klasat e sigurimit të jetës dhe për të jo-jetës, të ardhurat dhe shpenzimet nga investimi që janë të lidhura drejtpërdrejt me veprimtarinë e sigurimit të jetës do të përfshihen në llogarinë teknike të sigurimit të jetës.

Llogaria teknike, Jetë

Llogaria teknike (rezultati financiar nga aktiviteti i drejtpërdrejtë i sigurimit/ risigurimit) është e ndarë sipas klasave të sigurimit. Në ndryshim nga llogaria teknike e shoqërive të sigurimit të jo-jetës, në llogarinë teknike të shoqërive që kryejnë aktivitetin e jetës, rezultati teknik përveç të ardhurave nga primet teknike dhe shpenzimeve për dëmet, të shtuara ose të pakësuara nga rritja ose pakësimi i provigjoneve teknike të sigurimit për periudhën, do të përfshihen edhe të ardhurat/ shpenzimet e investimeve që vijnë nga produktet e lidhura me klasat e sigurimit të jetës. Të dhënat e pasqyruara në Llogarinë Teknike duhet të ndahen sipas klasave dhe grupimeve të mëposhtme:

1. Sigurim Jetë / Vdekje ;

2. Sigurim Martesë / Lindje ;
3. Sigurime të lidhura me fondet e investimeve ;
4. Sigurimi i administrimit të fondeve kolektive ;
5. Sigurime të jetës të mbështetura në llogaritje aktuariale.

Shoqëria e sigurimeve paraqet sipas kategorive të veçanta të sigurimeve rezultatin teknik të shoqërisë dhe rritjen e rezultatit nga sigurimet, sidiferencën midis të ardhurave dhe shpenzimeve nga investimet e financuara ,nga provizionet teknik dhe nga burime të tjera.

Llogaria "Fitime dhe humbje" ka për qëllim t'u japë përdoruesve të ndryshëm një informacion të mjaftueshëm për të ardhurat dhe shpenzimet që kanë qenë pjesë e formimit të rezultatit të shoqërisë.

Tema 4: Kostot në ndërmarrjet e sigurimeve dhe llojet e tyre

4.1. Nocionet bazë të kostove në shoqëritë e sigurimeve

Dimë që nocioni kosto ka të bëjë me tërësinë e shpenzimeve të kryera për një qëllim të caktuar. Kostot mund të analizohen duke iu referuar tri karakteristikave të pavarura.

- Së pari duke iu referuar fushës së zbatimit (për çfarë është llogaritur kostoja)
- Së dyti përmbajtjes (variabël, direkte, e plotë)
- Së treti momentit të llogaritjes (e parashikuar ose e konstatuar reale).

Analiza e kostove për aktivitete të ndryshme të njëjësive ekonomike bëhet në varësi të faktorëve të brendshëm të asaj njësie. Kosto mund të jenë:

- kosto të produkteve që lidhen me gjendjen inventariale dhe kanë të bëjnë me shitjet
- kostot që do të jenë në ngarkim të ushtrimit pa qenë nevoja të gjendet lidhja me shitjet apo të ardhurat e tjera, ndryshe quhen kosto të periudhës.
- Kostot e lidhura me funksione tregtare, administrative dhe të kërkimit ,parimisht janë kosto të periudhës.

Kostot e produkteve janë tërësia e shpenzimeve që i takojnë produkteve .Kostot e periudhës janë kosto ,të cilat nuk materializohen në produktin që prodhohet dhe parashikohet që të japin dobi vetëm në periudhën në të cilën janë kryer. Kostot në shoqëritë e sigurimeve, për të organizuar këtë biznes, kanë karakteristikat e tyre specifike, dhe ato duhet të mbahen në konsideratë. Duke pasur parasysh këto karakteristika, është më e lehtë të procedohet gjatë përpilimit të tarifave për produktet e sigurimeve. Në praktikën e sigurimeve, është zakon të bëhet dallimi midis kostove për organizimin e shërbimit të brendshëm të shoqërisë së sigurimeve dhe kostove për organizimin në rrejt të jashtëm të shoqërisë së sigurimeve. Në literaturën e specializuar ka klasifikime të ndryshme të këtyre kostove. Më të zakonshmet janë grupimet në shpenzime fikse dhe variabël, të varura dhe të pavarura, të përgjithshme dhe private për zhvillimin e këtij biznesi.

4.2.Llojet e kostove në shoqëritë e sigurimeve

Kostot e marrjes në sigurim

Kostot e marrjes në sigurim Jo-Jetë është një pasqyrë që jep një detajim të kostove të marrjes në sigurim të ndara sipas klasave të sigurimeve të aktivitetit të jo jetës. Totali i kostove të marrjes në sigurim të aktivitetit të jo jetës për të gjitha klasat e sigurimit duhet të jetë i barabartë me zërin “Shpenzime të marrjes në sigurim”. Do të klasifikohen si shpenzime të marrjes në sigurim ato shpenzime që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me marrjen e suksesshme në sigurim të policave të reja ose me rinovimin e kontratave të sigurimit ekzistuese.

1. Komisionet e ndërmjetësve

Në këtë zë përfshihen komisionet e paguara agjentëve (ndërmjetësve) për marrjen në sigurim dhe në risigurim të detajuara sipas klasave të sigurimit të aktivitetit të jo jetës.

2. Shpenzimet e marrjes në sigurim

Në këtë zë përfshihen shpenzimet e lidhura me nënshkrimin dhe rinovimin e kontratave të sigurimit, shpenzimet e përgjithshme të lidhura me verifikimin e aplikimeve dhe lëshimin e policave, shpenzime lidhur me procesin e vlerësimit të rrezikut të sigurimit duke përfshirë dhe shpenzimet e stafit/departamentit të marrjes në sigurim të detajuara sipas klasave të sigurimit të aktivitetit të jo jetës.

3. Shpenzime Marketingu

Në këtë zë përfshihen shpenzimet e marketingut që lidhen me produktet e sigurimit në veçanti (jo të shoqërisë) siç janë shpenzimet e reklamave dhe promovimeve të detajuara sipas klasave të sigurimit të aktivitetit të jo jetës.

4. Kosto të tjera të marrjes në sigurim

Në këtë zë përfshihen shpenzime të tjera të marrjes në sigurim të papërfshira në zërat e mësipërm.

4.3. Struktura e klasifikimit të kostove

Shpenzimet sipas natyrës, të regjistruara në kontabilitetin e përgjithshëm u korespondojnë në pikëpamje analitike-kostove. Këto kosto mund të analizohen sipas tri karakteristikave të pavarura:

1. Fushës së zbatimit që i përgjigjet pyetjes: Për çfarë llogaritet kostoja (çfarë funksioni, çfarë shërbimi, çfarë produkti).
2. Përmbajtjes: Kostoja mund të jetë më pak ose më shumë e plotë (variabël direkte e plotë).
3. Momentit të llogaritjes: Kostoja mund të jetë e parashikuar (standard) ose e konstatuar (reale).

Analiza e kostove për të cilat ndërmarrja duhet të organizoj sistemin e saj të kontabilitetit analitik, do të jetë në funksion të shumë faktorëve të brendshëm.

Kostot dallohen si:

1. Kosto e produkteve që kanë lidhje me gjendjet e inventarëve dhe do të lidhen me shitjet përkatëse
2. Kosto që do të jenë në ngarkim të periudhës ushtrimore, kur ato janë kryer pa qenë nevoja të gjendet një lidhje me të ardhurat e realizuara nga shitjet e tjera. Këto quhen zakonisht kostot e periudhës.

Në parim kostot e lidhura me funksionet tregtare, administrative dhe të kërkimit si dhe shpenzimet financiare janë kosto të periudhës.

Kosto variabël dhe kostot fikse

Dimë që klasifikimi i kostove në kosto fikse dhe kosto variabël bazohet në mënyrën se si kostot reagojnë kundrejt ndryshimit të vëllimit të veprimtarisë brenda kufijve të kapacitetit.

Kostot variabël janë proporcionale ose pothuajse proporcionale me një nivel të veprimtarisë ose prodhimit. Kostot fikse janë kosto, të cilat nuk ndryshojnë me ndryshimin e vëllimit të veprimtarisë brenda kufijve të kapacitetit. Kostot variabël mund t'i atribuohen një sigurimi të veçantë (lloji i sigurimit, politika e veçantë e sigurimit). Kostot fikse nuk mund të ndahen për një sigurim të veçantë. Ato duhet të shpërndahen në të gjithë portofolin e kontratave të lidhura të sigurimit. Konceptet e kostove fikse dhe të ndryshueshme përdoren në llogaritjet aktuariale për kontratat e sigurimeve që kanë një periudhë vlefshmërie më shumë se një vit. Kostot relativisht të fiksuara nuk i nënshtrohen luhatjeve në veprimtarinë e sigurimit, d.m.th. nuk varen

nga shkalla e punësimit të personelit në këtë organizatë sigurimesh. Shpenzimet e variabël ndryshojnë në përpjesëtim me shkallën e punësimit të personelit në këtë organizatë sigurimesh. Vlera e kostove relativisht fikse të shoqëruara me kualifikimet e punonjësve të kompanisë së sigurimeve e bën shoqërinë e sigurimeve të përpigjet të përmirësojë vazhdimisht aftësitë e punonjësve dhe agjentëve të saj të sigurimeve. Përqindja e kostove relativisht fikse për organizimin e biznesit është relativisht e vogël. Një vend më i madh në veprimtaritë e organizatës së sigurimeve zënë kostot variabël.

4.4. Kostot e komisionit, si dhe kostot e administrimit të shoqërive të sigurimit

Shoqëritë e sigurimeve përdorin ndërmjetësimin për arritjen e objektivave të tyre. Në praktikën e sigurimeve aplikohen lloje të ndryshme komisionesh. Tipet e komisioneve në ndërmjetësim janë:

Komisionet për shitje - ku ndërmjetësi për çdo kontratë sigurimi të shitur përfiton një përqindje, që në Shqipëri ka variuar nga 5 deri në 25 % për kohë të ndryshme dhe shoqëri të ndryshme.

Komisione të përsëritjes së kontratës – të cilat përfitohen vetëm në rastin kur klienti e përtërin në mënyrë aktive kontratën .Në rast të zgjatjes së kontratës në rrugë elektronike ,ndërmjetësi nuk e përfiton përqindjen e komisionit.

Komisionet mbi portofolin e policave të sigurimit – këto komisione varen nga volume i portofolit që konstatohet në një datë të dhënë.Në rastin kur numri i të siguruarve është më i vogël nga ai i rregjistruar në datën e referencës që shërben si krahasim,komisioni zvogëlohet ose reduktohet fare. E kundërta ,kur numri I të rregjistruarve është më i madh, edhe komisionet rriten.

Super - komisionet – ju jepen atyre ndërmjetësve që arritjen e objektivave përtej parashikimeve.

Komisionet e administrimit – që ka të bëjë me pagesën që përfitojnë ndërmjetësit nga siguruesit për: shpenzimetë përgjithshme të funksionimit të zyrave të tyre,shpenzimet për qiranë,pagesat e bashkëpunëtorëve, shpenzimet telefonike, shpenzime të arkëtimit etj.

Shpenzimet administrative ose kostot administrative janë ato shpenzime që bëjnë të mundur funksionimin e një ndërmarrjeje apo të një shoqërie.Këto lloj shpenzimesh ndahen në tri nëngrupe të mëdha.

1. **Shpenzime të marrjes në sigurim** – në këtë grup futen te gjitha shpenzimet që kanë të bëjnë me mbajtjen dhe funksionimin e departamenteve që kontaktojnë , kërkojnë, gjejnë ,informojnë dhe këshillojnë klientët.Gjithashu këtu futen: shpenzimet e karakterit publicitar, shpenzimet për pomovimin kompanië, sponsorizimet,etj.
2. **Shpenzime të funksionimit administrative** – këto shpenzime lidhen me mjediset,me zyrat , me pagat, me sigurimet shoqërore , me shpenzime për qeramarrje, me shpenzime për energjinë elektrike,ujë, mirëmbajtje,amortizimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale të amortizueshme,blerje kancelarie,transport,shpenzime për tatime,taksa si dhe detyrime të tjera fiskale.
3. **Shpenzime administrative financiare** – në këto shpenzime futen shpenzimet për likuidime dhe pagesa, huamarrjet e shoqërive të sigurimit, ato që kanë të bëjnë me faturimin e klientëve.

Tema 5: Llogaritja e kostove në ndërmarrjet e sigurimeve

5.1.Llogaritja e kostove në shoqëritë e sigurimeve

Raportimi i dëmit

Shoqëria e sigurimit duhet të shkruajë policat në gjuhë të kuptueshme dhe në përshtatje me terminologjinë ligjore. Në lidhje me raportimin e dëmit, policmbajtësit kanë detyrimin që përfshin:

- Përpjekjen për të minimizuar dëmin
- Raportimin në kohë të dëmit

Për të garantuar kryerjen sa më të lehtë të raportimit të dëmeve, shoqëria e sigurimit u dërgon palëve të interesuara, brenda një kohe të arsyeshme informacionin e nevojshëm që nga çasti i njoftimit të dëmit.

Marrja e raportimit të dëmit nga shoqëria

Njësia e dëmeve të shoqërisë duhet të jetë lehtësisht e kontaktueshme për pretenduesin e dëmit. Kur brokeri i sigurimit mund të jetë kontakti i parë, ky duhet t'i dërgojë raportimin shoqërisë menjëherë nga marrja e njoftimit për dëmin. Më pas kontaktohet përfituesi dhe i konfirmohet marrja e raportimit të dëmit. Në rast se gjykohet se dëmi nuk mund të paguhet menjëherë, njoftohet përfituesi se do të ri-kontaktohet brenda afateve të përcaktuara sipas akteve ligjore dhe nënligjore. Përfituesi njoftohet në mënyrë të menjëhershme edhe në rastin kur dëmi nuk mund të mbulohet nga policat e sigurimit.

5.2. Llogaritja e komisionit të agjensive në shoqëritë e sigurimeve

Tek risigurimi, kompania primare e sigurimit zakonisht i paguan risiguruesit pjesën e saj të primit bruto që merr mbi një risk. Pastaj risiguruesi i lejon kompanisë një kompensim të drejtpërdrejtë ose çedues mbi një prim të tillë bruto të marrë, i cili është në shumën e mjaftueshme për të rimbursuar kompaninë për komisionin që kompania u ka paguar agjentëve të saj, plus taksat dhe shpenzimet e saj të natyrës operative. Shuma e një kompensimi të tillë zakonisht përcakton fitimin ose humbjen për risiguruesin.

Klauzola e Shlyerjes – Një klauzolë në një marrëveshje risigurimi, e cila bën vlerësimin, pagesës dhe shlyerjen e plotë të gjithë obligimeve të ardhshme për humbjet e shkaktuara të risigurimit, pavarësisht natyrës vazhduese të disa humbjeve të caktuara siç janë përfitimet e pakufizuara mjekësore dhe të tërë jetës për Kompensimin e Punëtorëve.

Komisioni i Kushtit (ose Komisioni i Fitimit) – Një pagesë në formën e kompensimit që i bëhet kompanisë çeduese përveç pagimit të komisionit të çedimit normal. Ky është në formën e një përqindje të paracaktuar e fitimit neto të risiguruesit pas një pagese për shpenzimet e natyrës operative të risiguruesit, që rrjedh nga marrëveshja subjekt.

Komisionet për agjentët në sigurimin e përgjithshëm paguhet njëherë një vit. Ato tentojnë të jenë rreth 15% e primit çdo vit, por mund të jenë më të ulta për klasat e detyrueshme dhe më të larta linjat e lidhura me kreditin. Në tregjet eficientë shpenzimet operative janë zakonisht rreth 15% të primit bruto të shkruar

5.3. Llogaritja e kostove të administrimit

Shpenzime administrative

Në këtë zë përfshihen shpenzime të lidhura me mbledhjen e primeve, administrimin e portofoleve, bonuseve dhe rabateve, dhe të risigurimit (cedimit dhe risigurimit). Ky zë duhet të përfshijë në veçanti shpenzime të lidhura me stafin, shërbimet nga palët e treta, taksa dhe të ngjashme, shpenzimet e reklamave për shoqërinë në tërësi, amortizimin si dhe shpenzime të tjera administrative. Në këtë zë do të përfshihen edhe shpenzimet e shoqërisë në lidhje me dëmet e shkaktuara nga personat e pasiguar, pra dëmet që rrjedhin nga Fondi i Kompensimit, dhe të cilat nuk lidhen drejtpërdrejt me policat të shkruara nga shoqëria e sigurimit apo me

policmbajtës të kësaj shoqërie. Shpenzimet administrative siç e shohim janë mekanizmi që vënë në punë shoqërinë. Ato klasifikohen në tri grupe të mëdha:

1. Shpenzime të marrjes në sigurim
2. Shpenzime të funksionimit administrativ
3. Shpenzime administrative financiare

Në grupin e parë bëjnë pjesë të gjitha shpenzimet që kanë të bëjnë me mbajtjen dhe funksionimin e departamenteve që kërkojnë, gjurmojnë informojnë dhe këshillojnë klientin. Në rastin kur këtë shërbim e bëjnë agjentët dhe brokerat, në primin bruto duhet të përfshihet pjesa që u takon atyre. Në këto shpenzime gjithashtu bëjnë pjesë shpenzimet publicitare, pra të promovimit të shoqërisë dhe konsiderohet ndër shpenzimet më të rëndësishme për një shoqëri sigurimi. Në grupin e dytë futen të gjitha ato shpenzime që kanë të bëjnë me mjediset e punës, me punonjësit, me shpërblimet e tyre, me detyrimet ndaj sigurimeve shoqërore shëndetsore, me detyrimet tatimore, me detyrimet për energjinë elektrike, me shpenzimet për blerje kancelarie, me shpenzimet e transportit etj. Në grupin e tretë futen të gjitha ato shpenzime që kanë të bëjnë me likuidimet e pagesave, me huamarrjen e shoqërive të sigurimit apo të faturimit të klientëve. Shpenzimet administrative konsiderohen pjesë e natyrshme e primeve që faturojnë siguruesit. Në përbërjen e primit ka një pjesë të konsiderueshme që shkon për përballimin e shpenzimeve administrative. Qëllimi i siguruesve është që të ulën shpenzimet administrative për të mbajtur në nivele të ulta primin neto. Shpenzimet administrative duhet të mos kalojnë masën 10-12 % të primit të pastër duke bërë të mundur që shoqëria e sigurimit të ketë avantazhe në tregun e sigurimeve.

5.4.Llogaritja e kostove të kërkesave në humbje

Trajtimi i kërkesave për dëmshpërblim dhe pagesa e dëmshpërblimit.

Në rastin e ndodhjes së një ngjarje të siguruar ,siguruesi është i detyruar t'i japë të siguruarit dëmshpërblimin apo shumën e sigurimit, bazuar në kontratën e sigurimit. Siguruesi trajton çdo kërkesë për dëmshpërblim si dhe kryen pagesën brenda afatit të përcaktuar në kontratën e sigurimit. Trajtimi i kërkesave për dëmshpërblim ,nga ana e shoqërisë së sigurimit përfshin edhe vlerësimin e dëmit nga vetë shoqëria.

I siguruari ,me ndodhjen e ngjarjes së siguruar, gëzon të drejtën për t'u dëmshpërblyer. Në këtë moment siguruesi krijon nje sistem të brendshëm për trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim, dhe harton ,miraton procedura të brendshme për të trajtuar dhe zgjidhur këto kërkesa. Në lidhje me kërkesat në humbje regjistrohen një mori të dhënash që kanë të bëjnë me:

- “dëmet e pagura“
- “dëmet e raportuara“
- “dëmet e paguara nga risiguruesi“ etj

Ndryshimi në rezerva për dëme

Këtu do të listoheshin të dhënat lidhur me

“Provizione për dëme deri në 1 Janar të vitit financiar :dhe “provizione për dëme deri në 31 dhjetor të vitit financiar ku diferenca midis këtyre të dhënave është e barabartë me ndryshimin e këtij provizioni në llogarinë “Fitim dhe humbje të ,, të aktivitetit.

“dëmet pezull“, dëme të cilat janë raportuar pranë shoqërisë dhe është bërë një vlerësim paraprak ,i përafërt nga vetë shoqëria mbi masën e mundshme të pagesës së këtij dëmi pavarësisht se një pjesë e këtyre i takon të përballohet nga shoqëria.

5.5.Llogaritja e kostove në dëme

Mbulimi i përgjegjesisë së dëmeve nga pasuria ndihmon për të paguar dëmin e shkaktuar nga një automjet tjetër ose dëme të ndryshme të shkaktuara ndaj pronës. Sipas ligjit në vendin tonë ,çdo personi të cilit i është shkaktuar një dëm nga përdorimi i një mjete transporti, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim për humbjet apo dëmtimet e pësuar te personi përgjegjës, shoqëria ku është siguruar me policën TPL, mjete që shkaktoi aksidentin.

Shpenzimet për dëmet klasifikohen sipas grupeve të sigurimit duke paraqitur shumën bruto dhe shumën e risigurimeve. Ato përfshijnë vlerën e kompesimit për dëmin e ndodhur dhe shpenzimet e trajtimit të dëmit. Vlera e kompesimit për dëmin e ndodhur është shuma që përfitojnë personat e siguruar në rastin e ndodhjes së dëmit. Në shpenzimet e trajtimit të dëmit përfshihen shpenzime të brendshme dhe të jashtme që lidhen me trajtimin rastit të sigurimit si:

- Llogaritja e vlerës së dëmit
- Shpenzimet gjyqësore
- Shpenzimet për ekspertë.

Tema 6:Llogaritja e çmimit (primit) të produkteve në ndërmarrjet e sigurimeve

6.1.Metodat për llogaritjen e çmimit (primit) të produkteve të shoqërive të sigurimit, raste tipike të tyre.

Llogaritja e çmimit (primit) të produkteve të shoqërive të sigurimit është një process kompleks dhe me shumë përgjegjësi. Ekzistojnë disa mënyra për llogaritjen e primit të cilat kushtëzohen nga lloji i sigurimit të ofruar dhe risqeve të marra përsipër nga shoqëria e sigurimit. Në këtë process shumë i rëndësishëm është dhe roli i aktuarëve.Për të kuptuar llogaritjen e primit duhet të sqarohet tarifa e primit për njësi ekspozimi, pasi primi llogaritet mbi këtë njësi e cila ndryshon me llojin e sigurimit.Kjodotë thotë se primi mund të llogaritet për metër katror në sigurimin e banesave, llogaritet në bazë të shumës së siguruar (për çdo 100 euro) në sigurimn e jetës, llogaritet për një vit për mjetet motorike etj.

Llogaritja e primit në sigurimin e jetës dhe në sigurimin e jo-jetës është e ndryshme.

Metodat e llogaritjes së primit në sigurimet e jo-jetës janë:

- Metoda e primeve sipas klasave të riskut – sipas kësaj metode kemi grupim të risqevetë njëjta dhe për secilën klasë llogaritet primi i pastër i riskut(primi i mjaftueshëm për të paguar dëmet)dhe shtesat e tjera.
- Metoda e primeve sipas gjykimit të ekspertëve - në këtë metodë merret në konsideratë gjykimi i ekspertëve, i cili në shumicën e rasteveështë nënshkruesi i policave të sigurimit.
- Metoda e llogaritjes së primeve sipas eksprincës – bazohet në metodën e klasave të riskut, por në dallim të saj ,primi për secilin të siguruar ë marrë në sigurim përcaktohet nga eksperienca e mëparshme e të siguruarit.
- Metoda retrospective - sipas kësaj metode, primet e periudhës përcaktohen nga dëmet e paguara në këtë periudhë,domethënë të siguruarit paguajnë një prim paraprak të përlllogaritur në fillim të periudhës.Në fund të periudhës primi rillogaritet duke marrë për bazë dëmet aktuale të paguara nga shoqëria e sigurimit
- Metoda e skeduleve të primit – sipas kësaj metode primi bazë i llogaritur për një lloj risku të një ekspozimi të quajtur standart ,korrigjohet me shtesa dhe zbritje në varësi të rrethanave dhe karakteristikave individuale të objekteve të marra në sigurim.Shembull tipik është sistemi bonus-malus i përdorur në sigurimin e mjeteve motorike

6.2.Pjesët përbërëse të kalkulimit të çmimit të produktit

Primi është “çmimi „ i një produkti jomaterial, siç janë produktet në sigurime.Si çdo lloj çmimi tjetër dhe primi ka pjesët e veta të përbërjes.Elementi i parë që dallohet si pika e nisjes në teknikat e llogaritjes së primit, është primi i pastër/ primi i riskut.

- 1. Primi i pastër** është primi që llogarisin aktuarët duke u nisur nga statistikat dhe propabiliteti i ndodhjes së ngjarjeve që prodhojnë dëm financiar.Të dhënat statistikore si rregull i përkasin një periudhe midis 50 – 100 vjet.

Në qoftë se do e shprehim nga ana sasiore, primi i pastër do te llogaritej:

$$\text{Primi i pastër} = \frac{\text{Shuma e dëmeve për t'u paguar}}{\text{Numri i njësive të ekspozuara}}$$

Shembull: Primi i sigurimittë automjeteve (vetura)

Supozomë se në Tiranë ka 200 000 vetura të ndryshme.Vlera mesatare e një veture të siguarar është 12 000 euro (shuma e siguarar).Në 25 vitet e fundit është vërtetuar se propabiliteti i përplasjes së tyre është 2% dhe se vlera mesatare e dëmit të shkaktuar nga një aksident i pësuar është 3 000 euro.Llogarisim numrin e automjeteve që me propabilitet përfshihen në një aksident çdo vit.

$$200\,000 \text{ vetura} \times 2\% = 4.000 \text{ vetura të dëmtuara}$$

Dëmi gjithsej = 4 000 vetura x 3 000 euro = 12 000 000 euro.

Vlera prej 12 000 000 euro është dëmi i pastër i cili do të përballohet nga kontributi i gjithë komunitetit të pronarëve të veturave .Për këtë qëllim ata duhet të paguajnë një prim të pastër të barabartë me: **12 000 000 euro / 200 000 vetura = 60 euro.**

- 2. Primi neto** = Primi i pastër + shesat për risqe

Primi neto = Primi i pastër + shtesa për marzh sigurie + shtesa për akumulim risqesh + shtesa për risqe katastrofike + shtesa për risku e rritjes së çmimeve.

Shembull: nëse i referohemi shembullit të mësipërm dhe të dhënave të tilla si:

Shtesa për akumulim të risqeve = 5% x 60 = 3 euro

Shtesa për marzh sigurie (ndryshim grupmoshe) = 25% x 60 = 15 euro

Ndryshim + rritje çmimesh në riparim = 15% x 60 = 9

Primi neto = 60 euro + 27 euro = 87 euro

- 3. Primi bruto** = Primi neto + shtesa shpenzime administrimi + shtesa marzh fitimi – interesa financiare të arkëtuara

Primit neto ibëhen tri korrigjime për të arritur te primi bruto

Shembull: vazhdojmë me referimin te shembulli i mësipërm. Supozojmë se një shoqëri sigurimesh synon një marzh 15% në vit mbi shpenzimet administrative të veturave .Ndërkohë 6 000 000 euro është shuma mesatare e primeve motorike me normë interesi 5%, në bono thesari me afat maturimi 1 vjeçar. Shoqëria shpenzon 3 milion shpenzime administrative.

Mbi këto shpenzime ajo llogarit 3 000 000 euro x 15% = 450 000 euro marzh

Kësaj shume i zbritet interesi i investimit në bono të pjesës së primeve, dmth

$$6\,000\,000 \text{ euro} \times 5\% = 300\,000 \text{ euro.}$$

Shtesat administrative neto = 3 000 000 euro + 450 000 euro – 300 000 euro = 3 750 000 euro.Shtesa për veturë është 3 750 000 / 200 000 = 18.8 euro/veturë.

Pra primi bruto i veturave = 87 euro + 18.8 euro = 105.8 euro / veturë.

4. Primi kontraktual = primi bruto (+/-)shitesa (zbritje) të lidhura me klientin

Shembull: vazhdimi i referimit. Nëse shoqëria për të gjitha automjetet e marra në sigurim aplikon zbritjen 10%, atëherë do të kemi:

Primi bruto = 105.8 euro,

Zbritjet për cilësi dhe veçori të klientëve prej 10% mbi primin bruto = 105.8 euro x 10% = 10.58 euro

Primi kontraktual do të jetë: 105.8 – 10.58 = 95.22 euro

5. Primi i paguar (i faturuar) = primi kontraktual – bonus + malus

Ky është primi që I faturohet dhe paguan me të vërtet klienti ose duke zbritur bonus (një vit pa dëme) në rata që ka qenë e parashikuar ,ose duke shtuar “ malus “,penalitete në rata që pësojnë shumë dëme.

6.3.Llojet e çmimit (primit) të produktit

Që shoqëria e sigurimit të vendosi çmimet e sakta ka nevojë për të dhëna historike.Sa më shumë të dhëna të jenë disponibël aq më i saktë do jetë çmimi dhe aq më të ulta do jenë fluktacionet në rezultatet e pritshme. Komponenti kryesor janë dëmet.Informacioni për dëmet duhet të jetë sa më i gjerë dhe më i plotë.Për produkte me frekuencë të lartë si psh Kasko, periudha e shqyrtimit mund të jetë më e shkurtër psh 5-10 vjet.Për produkte me frekuencë të ulët si psh Sigurimi nga Tërmeti, periudhat me të dhëna duhet të jenë të gjata.Në mungesë të këtyre të dhënave kompanitë përdorin indekse globale të përlllogaritura nga qendra të specializuara (risigures ndërkombëtar apo qendra kërkimore).Pjesa që i takon shpenzimeve përlllogaritet më thjeshtë në bazë të strategjive të kompanisë.Përcaktimi i primeve i referohet formimit të çmimeve të sigurimit. Formimi i çmimeve të sigurimit ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga formimi i çmimeve të produkteve të tjera.Kur produktet e tjera dalin në shitje, tregtarët kryesisht e dinë që më pare se sa është kostoja e tyre, prandaj dhe çmimet vendosen të tilla që të mbulojnë të gjitha kostot dhe të sigurohet përfitimi. Ndërsa, siguruesit nuk e dinë paraprakisht se sa do të jetë kostoja. Primi i përcaktuar për sigurim mund të jetë jo i përshtatshëm për të paguar të gjitha dëmet dhe shpenzimet përgjatë vlefshmërisë së policës së sigurimit. Vetëm pas përfundimit të periudhës së mbulesës sigurorese,siguruesi mund të përcaktojë humbjet e tija aktuale dhe shpenzimet. Sigurisht që siguruesi shpreson se primet e paguara në avanc do të jenë të mjaftueshme për të paguar të gjitha dëmet dhe shpenzimet si dhe të sigurojnë fitim.

Primi i sigurimit të jojetës

Primi i sigurimit të jojetës përbëhet nga:

- a) primi i rrezikut;
- b) pjesa e llogaritur për mbulimin e shpenzimeve të marrjes në sigurim dhe shpenzimeve administrative, përfshirë dhe komisionet;
- c) pjesa e llogaritur për fitimin e shoqërisë së sigurimit.

Primi i rrezikut është pjesa e primit, e llogaritur për pagimin e dëmeve, sipas dispozitave të përcaktuara në kontratat e sigurimit.

Primi i sigurimit i jetës

Primi i sigurimit i jetës përbëhet nga:

- a) primi i rrezikut;
- b) pjesa e llogaritur e primit për provigjionet matematike – elementet e kursimit;
- c) pjesa e llogaritur për mbulimin e shpenzimeve të marrjes në sigurim dhe shpenzimeve administrative, përfshirë dhe komisionet;
- ç) pjesa e llogaritur për fitimin e shoqërisë së sigurimit, përfshirë këtu fitimin nga investimet, duke marrë parasysh rrezikun që i përket këtyre investimeve

6.4. Llogaritja e çmimit (primit) në shoqëritë e sigurimit për shëndetin

Sigurimi shëndetsor në Republikën e Shqipërisë është pjesë e sistemit bazë të sigurimit të detyrueshëm. Kjo pjesë e sigurimit të detyrueshëm ju ofron shtetasve shqiptar mbrotjen nga risqet që kërcënojnë shëndetin, shërbimet spitalore, reduktimin e çmimeve për produktet farmaceutike. Ligji për këtë sigurim klasifikon të siguruarit në dy kategori të mëdha: persona ekonomikisht aktive dhe persona ekonomikisht joaktive. Ndryshimi midis këtyre kategorive qëndron në faktin se personat ekonomikisht aktive i paguajnë vetë kontributet, ndërsa për personat ekonomikisht joaktive paguan buxheti i shtetit. Kontributi i detyruar që ka pamjen e primit të sigurimit, është një pagesë, e cila paguhet dhe nga punëmarrësi dhe nga punëdhënësi. Çdonjëri nga kontribuesit, punëmarrës dhe punëdhënës, paguan njëherësh edhe kontributet për kontributet për sigurimet shoqërore, edhe kontributet për sigurimet shëndetsore. Që të sqarojmë këtë pjesë duhet të kujtojmë edhe njëherë konceptin e pagës bruto dhe pagës referuese. Paga bruto, për efekt të llogaritjes së kontributeve shoqërore e shëndetsore, është paga e caktuar sipas legjislacionit në fuqi, ose në kontratën e punës sipas rastit me kohë ose vëllim pune dhe shtesat e tjera, me karakter të përhershëm që lindin nga marrëdhëniet e punës. Paga bruto evidentohet në listëpagesën tip, e cila është deklarata për pagesë dhe dokumenti bazë për evidentimin e kontributeve individuale. Punëmarrësit, sipas ligjit që është në fuqi që nga viti 2014 paguajnë një kontribut për çdo punonjës, në masën 15 % të pagës referuese për sigurimin shoqëror. Punonjësi vetë ose punëmarrësi paguan një kontribut për sigurimet shoqërore në masën 9.5 % të pagës referuese. Duhet të theksojmë se masa në përqindje e llogaritjes dhe pagesës së detyrimit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore, si dhe mënyra e llogaritjes së tyre për të dy forcat kontribuese, punëmarrës dhe punëdhënës, kanë qënë shpesh objekt i ndryshimeve të shpeshta prej qeverisjeve të ndryshme ndër vite. Paga referuese është një segment i kufizuar prej Qeverisë në boshtin e pagës, dhe që aktualisht është 105.850. Konsiderohet pagë referuese një segment nga paga e punonjësit që ka dy kufij limit: pagën minimale referuese dhe kufirin maksimal të pagës referuese. Kontributi i detyrueshëm thamë që është për pjesën shoqërore dhe shëndetsore. Duhet të theksojmë se për llogaritjen dhe pagesën e kontributit të detyruar të sigurimeve shëndetsore, që nga 1 janari i vitit 2014 nuk ka pagë referuese. Detyrimi për këtë kontribut llogaritet mbi pagën bruto. Masa e këtij detyrimi për individ është 3.4%. Kjo masë paguhet 1.7 % nga punëdhënësi dhe 1.7 % nga punëmarrësi.

Le ta ilustrojmë me një shembull:

Le të supozojmë se në ndërmarrjen START, punon punonjësi: z A. Toska (të ardhurat janë në lekë)

Punonjësi	Paga bruto
A. Toska	150.000

Llogarisim sigurimet shoqërore dhe shëndetsore të punëdhënësit dhe punëmarrësit për z. Toska.

Paga bruto = 150.000, për efekt të llogaritjes së sigurimeve shoqërore do të marrim në konsideratë pagën referuese që është 105.850 lekë. Atëherë, detyrimet e punonjësit/punëmarrësit për sigurimet shoqërore janë:

Paga referuese * 9.5 % = 105.850 * 9.5 % = 10,055.75 lekë

Detyrimet për kontributin e sigurimeve shoqërore janë:

Paga bruto * 1.7 % = 150.000 * 1.7 % = 2,550 lekë

Detyrimet e punëdhënësit për sigurimet shoqërore janë:

Paga referuese * 15% = 105.850 * 15 % = 15,877,5

Detyrimet për kontributin e sigurimeve shoqërore janë:

Paga bruto * 1.7 % = 150.000 * 1.7 % = 2.550 lekë

6.5. Llogaritja e çmimit (primit) për sigurimin e pasurisë dhe mjeteve motorike në shoqëritë e sigurimeve

Sigurimi i detyrueshëm i mjetit motorik në sektorin e transportit është sigurimi i përgjegjësive së pronarit ose të përdoruesit të mjetit motorik për dëmet shkaktuar palëve të treta nga përdorimi i këtij mjete. Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare ka miratuar udhëzimin “Mbi zbatimin e sistemit Bonus-Malus në sigurimin MTPL e brendshme”. Udhëzimi përcakton kriteret për llogaritjen e skemës universale të sistemit “Bonus-Malus” që do të zbatohet nga të gjitha shoqëritë e sigurimit që ofrojnë produktin TPL e brendshme në kategoritë B1 (autovetura) dhe B2 (furgona, mikrobuzë).

Sistemi "Bonus-Malus" është mekanizmi i tarifimit në sigurimin e detyrueshëm MTPL, ku primi i zbatuar është i varur nga historiku i dëmeve/eksperiencës së drejtimit të automjetit nga ana e të siguruarit. Ky sistem penalizon ekonomikisht, me rritjen e primit (deri në dyfishimin e tij), të siguruarin përgjegjës për një ose më shumë aksidente të shkaktuara/raportuara gjatë periudhës së sigurimit. Në anën tjetër, e favorizon atë me ulje të çmimit të primit të sigurimit (deri në përgjysmim), nëse gjatë periudhës së konsideruar nuk ka shkaktuar asnjë dëm.

1. Policë Kufitare
2. Sigurimin e pasagjerëve në transportin publik

Sigurimi TPL – Primi i sigurimit varion në përputhje me vitin e prodhimit, tipin e mjetit, fuqinë motorike, dhe kapacitetin e mjetit të siguruar. Si kriter shtesë për llogaritjen e primit me implementimin e sistemit Bonus – Malus, do të jetë dhe numri i aksidenteve që një drejtues mjete ka shkaktuar më parë. Metodologjia e përcaktimit të primit miratohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Primi i sigurimit llogaritet si shumë e primit të rrezikut plus ngarkesa mbi primin e rrezikut. Ngarkesa mbi primin e rrezikut përcaktohet nga sigurosi, bazuar në tabelat emiratuara të primit të rrezikut, në planin e saj të biznesit për produktin dhe në vlerësimet eaktuarit të saj të autorizuar. Niveli i ngarkesës mbi primin e rrezikut nuk duhet të kalojë masën 30% të primit të sigurimit. Llogaritja e primit për Kartonin Jeshil bëhet duke u bazuar në të dhënat për dëmet e paguara dhe dëmet pezull të pashpërndara.

3. Sigurimi KASKO-Siguron mbulim për humbje apo dëmtim të mjetit motorik të shkaktuar nga rreziqet të ndryshme

Primi i sigurimit mund të variojë në bazë të vlerës së mjetit motorik si dhe skemës së sigurimit të zgjedhur nga vetë klienti.

Çdo kompani ka një sistem tarifash për produktet standarte. Le të shohim disa raste:

Sigurimi KASKO

Personi që aplikon për sigurimin KASKO, zgjedh mbulimet që kërkon të ketë.

Jep vlerën e automjetit tek agjenti i sigurimit. Nëse ai nuk ka dijeni për vlerën e automjetit, kompania e sigurimeve i referohet katalogëve të caktuar, për përlllogaritjen e vlerës, në bazë të vitit të prodhimit, modelit, kilometrave etj. Supozojmë që vlera e automjetit është 20.000 Euro. Personi kërkon të sigurojë Full KASKO Brenda Shqipërisë. Në tabelën e tarifave të mbulimeve do të gjejmë që ky mbulim është 2.7% e vlerës së automjetit.

$$\text{Primi} = 20.000 \times \frac{2.7}{100} = 540 \text{ euro}$$

Aktualisht në sigurime aplikohet një taksë 10% dhe nuk aplikohet në TVSH. Kjo taksë aplikohet mbi primin e sigurimit

$$540 \text{ euro} * 10\% = 54 \text{ euro}$$

Totali për të paguar do të jetë: 540 euro + 54 euro = 594 euro

Sigurimi i Aksidente Personale.

Tarifat për Sigurimin e Aksidente Personale janë të grupuara në disa klasa në varësi të rrezikshmërisë që paraqet profesioni i tij

Klasa sipas profesioneve	Tarifa per mije
Klasa I	3
Klasa II	4
Klasa III	5
Klasa IV	6

Personi që aplikon për sigurimin Aksidente Personale, zgjedh Shumën e Sigurimit që kërkon të ketë. Supozojmë që shuma e sigurimit është 50.000 Euro. Deklaron Profesionin e tij tek agjenti i sigurimit. Agjenti i Sigurimit, në manualin që ka, gjen se cilës klasë i përket profesioni i tij. Supozojmë që personi që do të sigurohet punon në një gurore. Ky paraqet një rrezikshmëri të lartë, dhe i përket klasës IV, tarifa për të cilin është 6 për mijë.

$$\text{Primi} = 50.000 \frac{6}{1.000} = 300 \text{ euro}$$

Llogarisim taksën 10% që aplikohet mbi primin:

$$\text{Taksa} = 300 \text{ euro} * 10\% = 30 \text{ euro}$$

Totali i primit 300 euro + 30 euro = 330 euro

Sigurimin e Pronës

Sigurimin e Pronës janë tarifa të grupuara në disa klasa në varësi të rrezikshmërisë që paraqet biznesi me aktivitetin e tij.

Lloji I Biznesit	Tarifa per mije
Industrite (perpunim mineralesh, metalesh, qelqi, HEC, etj.	1.5 deri ne 3.5
Hotelet dhe restorantet	1 deri ne 2
Dyqane dhe qendra tregtare	1
Zyra Administrative	1
Stacione RTV	1.5
Studio Filmi	1.5
Spital	0.8
Teater	1.2
Salle Sporti	1.5
Avion, Mjet lundrimi	1.5

Personi që aplikon për sigurimin e pronës, zgjedh rreziqet që kërkon të ketë. Në tabelën e tarifave, kemi dhënë tarifa orientuese vetëm për zjarrin dhe tërmetin. Për rreziqet e tjera bëhet inspektim më i detajuar i pronës. Supozojmë që shuma e sigurimit (vlera e zyrave që do të sigurohen) është 250.000 Euro. Në tabelë, tarifa për këtë lloj biznesi është 1 për mijë.

$$\text{Primi} = 250.000 \cdot \frac{1}{1.000} = 250 \text{ euro}$$

Taksa = 250 euro * 10% = 25 euro

Totali i primit = 250 euro + 25 euro = 275 euro

Tema7: Marzhi dhe tatimi i shërbimeve të sigurimeve

7.1 Analiza e pasqyrës së shpenzimeve dhe të ardhurave ,ndikimi në rezultat

Çdo ngjarje dhe transaksion i ndodhur gjatë një viti ushtrimor regjistrohet dhe dokumentohet në librat dhe pasqyrat e kontabilitetit. Dokumentimi i këtyre ngjarjeve u shërben administratorëve ,aksionerëve dhe kujtdo tjetër për të gjykuar mbi gjendjen financiare të shoqërisë. Një nga këto dokumenta është dhe pasqyra e të ardhurave dhe e shpenzimeve (PASH). Një shoqëri sigurimi realizon të ardhurat nga sigurimet, bën shpenzime për mbulim humbjesh e të tjera dhe në fund nxjerr rezultatin fitim/humbje që shoqëria e sigurimit ka realizuar përgjatë një viti ushtrimor. Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve analizon:

Të ardhurat e një shoqërie sigurimi që realizohen nga 3 burime themelore:

- a) të ardhura nga primet
- b) të ardhura nga investimet
- c) të ardhura të tjera të shoqërisë

a) Të ardhura nga primet e fituara- janë të ardhura nga prime të arkëtuara për të cilat ka mbaruar periudha e mbulimit;

b) Të ardhura nga investimi i parave të arkëtuara nga primet, investimi në depozita , bono thesari , obligacione etj.

c) Të ardhurat e tjera të shoqërisë përfshijnë çdo lloj tjetër të ardhure dytësore që nuk bën pjesë në dy grupet e para.

Në shoqëritë e sigurimeve, paraqitet sipas kategorive të veçanta ndikimi në rezultatin teknik të sigurimeve si dhe rritjen e tyre, si diferencë kjo e të ardhurave me shpenzimet nga investimet e financuara nga provizionetteknike të sigurimeve dhe nga burime të tjera.

Rezultati teknik i sigurimeve = të ardhura nga primet teknike – shpenzimet për dëmet (të shtuara ose të pakësuara nga rritja ose pakësimi i provizioneve teknike të sigurimit për periudhën)

Shpenzimet e një shoqërie sigurimi përfshijnë:

- a) Humbjet / dëmet që i paguhen të siguarave;
- b) Shpenzimet për verifikimin , matjen, sistemin e këtyre humbjeve
- c) Shpenzime administrimi(shpenzime punësimi, shërbime të kryera nga të tretët, taksa , shpenzime të amortizimit, shpenzime të tjera administrative, shpenzime të tjera operative)

Analiza sipas zërave të të ardhurave përqendrohet tek primet e fituara që janë prime të arkëtuara në periudhën e kaluar dhe atë ushtrimore për të cilët ka kaluar periudha e mbulimit në sigurim apo ka skaduar polica e sigurimit.

7.2. Llogaritja e marzhit bruto

Marzhi bruto nënkupton të ardhurat e një produkti minus shpenzimet e produktit dhe jep fitimin e produktit. Kjo është një pasqyrë që raportohet e veçantë e cila quhet llogaria teknike. Marzhi i fitimit është pjesë përbërëse e primit bruto gjë që tregon se edhe kompanitë e sigurimeve funksionojnë mbi baza tregtare dhe se siguruesit janë të interesuar për pjesën e tyre të fitimit. Kjo do të thotë që siguruesit, primit neto, i shtojnë përveç shpenzimeve të administrimit edhe një marzh fitimi. Marzhi i fitimit duhet të llogaritet si përqindje shtesë mbi shpenzimet e karakterit administrativ. Dimë që shpenzimet e karakterit administrativ luhaten 10-12 % të primit të pastër, ndërsa marzhi i fitimit mund të llogaritet në masën 12 – 18 % të shpenzimeve administrative. Kjo masë është relative pasi ndikohet nga shumë faktorë dhe është një tregues që mat dhe tregon sa sa eficient është tregu dhe ashpërsia e konkurrencës midis shoqërive të sigurimit. Shoqëritë e sigurimeve e llogarisin marzhin e fitimit mbi shpenzimet administrative për faktin se ato duhet të fitojnë një përqindje për kapitalin e investuar. Nga ana tjetër ato investojnë në mënyrë të përhershme kapitalin dhe çdo vit investojnë vetëm shumën e shpenzimeve administrative. Kështu që niveli i përfitimit si përqindje mbi shpenzimet administrative është element i konkurrencës dhe kthimit të investimit në fushën e sigurimeve. Duhet të theksojmë se marzhi i fitimit nuk është elementi i vetëm i fitimit për shoqëritë e sigurimeve.

Llogaria “Fitime dhe humbje “

Llogaria “Fitime dhe humbje “, e dimë se ndërtohet si rezultat i xhirimeve të të ardhurave dhe shpenzimeve të kryera gjatë vitit kontabël ose periudhës ushtrimore. Mbyllja e kësaj llogarie jep rezultatin e shoqërisë .Pra diferenca midis tepicës kreditore (shuma e të ardhurave të realizuara) me tepicën debitore (shuma e shpenzimeve të bëra) jep rezultatin që mund të jetë Fitim ose Humbje. Në rastin kur kjo diferencë është positive do të se shoqëria ka realizuar fitim dhe ky është fitimi neto.

Tema 8: Kontabilizimi i veprimtarisë në ndërmarrjet e sigurimeve

8.1. Regjistrimet kontabël për nisjen e veprimtarisë së një shoqërie sigurimi

Shoqëria e sigurimit themelohet vetëm si shoqëri aksionare.

Për të kuptuar si funksionon hapja dhe rregjistrimi i shoqërisë në rregjistrat kontabël, le të marrim një shembull. Supozojme se tri shokë kanë vendosur të krijojnë një shoqëri sigurimesh. Në datën 7 janar të vitit 2018 në mbështetje të Aktit të themelimit dhe Statutit, kanë nënshkruar kapitalin themeltar (aksionet). Kapitali i nënshkruar është 900 000 000 lekë dhe përbëhet nga 900 000 aksione me vlerë nominale të një aksioni 1000. Në librin përkatës çdo aksioner ka të rregjistruar pjesën e vet të aksioneve. Në 31 janar 2018 përfundon derdhja në bankë e vlerës së aksioneve që ka nënshkruar secili aksioner për kapitalin themeltar në total 900 000 000, dhe me këtë veprim, shënohet në listën e emrave të aksionerëve likuidimi I vlerës së aksioneve.

Në kontabilitet këto dy veprime do të rregjistroheshin me artikujt kontabël:

Ref	Përshkrimi i veprimit	Shuma debi	Shuma kredi
	Kapitali i nënshkruar	900 000 000	
	Te		
	Kapitali themeltar		900 000 000

	Kontabilizohet nënshkrimi i kapitalit të aksionerëve		
	Banka Te Kapitali i nënshkruar Kontabilizohet derdhja në bankë e vlerës së aksioneve nga aksionerët për kapitalin themeltar	900 000 000	900 000 000

Shoqëria e sigurimit, përveç kapitalit themeltar duhet të ketë edhe fond shtesë për të mbuluar shpenzimet e themelimit, të funksionimit dhe të administrimit, i cili në çdo rast nuk duhet të jetë më i vogël se 5 për qind e kapitalit themeltar i quajtur ndryshe “fond për shpenzime nisjeje”. Atëherë, sipas ligjit, në 01 prill 2018 realizohet derdhja në bankë e Shpenzimeve të nisjes nga aksionerët e shoqërisë. Në masën 5% të vlerës së kapitalit themeltar. Vlera totale e shpenzimeve të nisjes është $(900\,000\,000 * 5\%) = 45\,000\,000$. Secili aksioner derth 5% të vlerës së aksioneve që zotëron për shpenzimet e nisjes. Ky veprim në kontabilitet do të rregjistrohej me artikullin:

Ref	Përshkrimi i veprimit	Shuma debi	Shuma kredi
	Banka Te Shenzimet e nisjes Kontabilizohet derdhja në bankë e shpenzimeve të nisjes $(900\,000\,000 * 5\%)$	45 000 000	45 000 000

Shoqëritë e sigurimit investojnë Fondin e Garancisë vetëm në:

- Bono thesari njëvjeçare (12-mujore të Qeverisë Shqiptare);
- Depozita bankare me afat maturimi jo më të vogël se 1 vit në një nga bankat dhe/ose degët e bankave të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në rastin e shembullit tonë, themi se në 30 maj 2018 në zbatim të vendimit të asamblesë së ortakëve 82 % e kapitalit themeltar shkon për investim të fondit të garancisë në Depozita Bankare $(900\,000\,000 * 82\%) = 738\,000\,000$ dhe 18 % e kapitalit themeltar shkon për investim të fondit të garancisë në Bono Thesari $(900\,000\,000 * 18\%) = 162\,000\,000$.

Në kontabilitet veprimet e mësipërme do të rregjistroheshin me artikujt e mëposhtëm:

Ref	Përshkrimi i veprimit	Shuma debi	Shuma kredi
	Depozita Te Banka Kontabilizohet investimi i kapitalit në Depozita bankare	738 000 000	738 000 000
	Letra me vlerë (Bono Thesari) Te Banka Kontabilizohet investimi i kapitalit në Bono Thesari	162 000 000	162 000 000

Pjesa tjetër e blerjes së aseteve si (ndërtesë, mjete transporti, pajisje zyre, etj) rregjistrohen në llogartë përkatëse sipas rregullit të regjistrimit të dyfishtë të mësuar në kontabilitetin e klasës së 10.

8.2.Koncepti mbi policën e sigurimit, kontabilizimi i saj

Nëse përdorim termat “kontratë sigurimi“ dhe “policë sigurimi“ kemi thënë dy gjëra me të njëjtin kuptim.

Kontrata është një marrëveshje ligjërish të zbatueshme në të cilën pasqyrohen të drejta dhe detyrime për palët që e nënshkruajnë atë.Kontrata konsiderohet e prishur nëse njëra nga palët nu arrin të përmbush detyrimet e saj ,pa patur një arsye ligjore.

Polica e sigurimit është një kontratë e shkruar dhe e plotë sigurimi që shpreh dhe rregullon interesat dhe raportet e të siguruarit me siguruesin,që bën funksionale një marrëveshje në sigurim ,për të pasur vlerën e provës materiale. Pra kontrata e sigurimit duhet të plotësojë të njëjtat kërkesa si kontratat e tjera të vlefshme. Kontratat e sigurimeve hartohen në zbatim dhe respekt si rregull të dy ligjeve bazë:të Kodit Civil ,apo të Kodit tregtar dh të ligji specifik të fushës.Ato janë komplekse dhe të natyrave të ndryshme, si rrjedhojë e larmisë së produkteve që ofrojnë shoqëritë e sigurimit.Pjesët kryesore të një police sigurimi janë :

- Deklarimet ,të cilat bëhen sipas formateve përkatëse
- Përkufizimet për konceptet dhe pikat e kontratës
- Marrëveshjet e sigurimit
- Përjashtimet kontraktuale
- Kushtet kontraktuale
- Pika të ndryshme kontraktuale

Dimë që shoqëritë e sigurimeve “shesin premtime“, kjo dotë thotë që kur blihet një sigurim realisht është blerë një premtim që për të ardhmen ku dëmi i pësuar mund të mbulohet nga siguruesi. Raportimi Financiar i shoqërive të sigurimit bëhet mbi bazë të Standartave Ndërkombetare të Kontabilitetit (IFRS).

Më poshtë jepet modeli i një kontrate sigurimi të detyrueshëm mjeteve motorike dhe më pas artikujt kontabël për regjistrimin e saj:



Nr. i serisë 19 0052796

KOD RAPORTIMI

A93301759F58E6445A43ED4

INTERSIG VIENNA INSURANCE GROUP SH.A (B1/2.1)Autoveturë 1600-2500cm3 >2008

NIPT:K12201002T

Nr. 94



Data 04/03/2019



POLICË PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM TË MBAJTËSVE TË MJETEVE MOTORRIKE PËR PËRGJEGJËSINË NDAJ PALËVE TË TRETA

SIGURUESI		Dega / Agjencia		Telefon/Fax	
INTERSIG VIENNA INSURANCE GROUP SH.A					
I SIGURUARI / PËRDORUESIT					
Pronesia: PORSCHE LEASING		Nipti / Kodi Fiskal: L31823006N		Adresa /Tel/Fax:	
Përdoruesit:		Gjinia		Detalhetidje	
Sipas Autorizimit				Drejtimi afërsisht	
				Adresa /Tel/Fax:	
				Njesia bashkiake nr 5, rruga Peter Ba	
MJETI MOTORRIK					
Targa	Kategoria	Klasa	Marka	Modeli	Niveli
AA RC	B1/2.1	B1/2.1	AUDI	A6	ZEZE
Viti i prodhimit	Numri i aksionit		Numri i veturës	Kapaciteti motorit	Paqja motorike
2017	WALUZZ2405HN100146		5	2270	1984
PERIUDHA E SIGURIMIT		14/03/2019		deri	13/03/2020
PRIMI I SIGURIMIT		Vlera në %		Vlefte pa TVSH	TOTALI
Data e pagesës: 04/03/2019		Primi i Shkrimit		16705	16705
		** Taksa tibi primiu		10 %	1670
				TOTALI	18375

401PPEB19063-4730

Kontrata e sigurimit kën në fuqi në veçanti 24 të ditëve së fillimit të periudhës së sigurimit.
 Kjo policë sigurimi është bashkuar me bazën e dispozitave ligjore në fuqi, si dhe aktive të tjera rregulluese, të cilat rregullojnë veprimtarinë e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta.
 (Dokumenti nr 4677 dt. 27.03.2009, Ligji nr 10076 dt. 13.02.2009)
 Përdoruesi i kësaj policë si faturë tatimore është lejuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me autorizim Nr. 1 dt. 05.02.2003.
 Une i siguruari jam dakort me kushtet e përgjithshme dhe përjashtimet e shprehura në faqen e parme të policës.

I SIGURUARI: PORSCHE LEASING (Emër/Mbështetë Firmë)
 AGJENTI: Star Broker shtet TPL BROKES NE SIGURIME (Emër/Mbështetë Firmë)
 LËSHUAR NË PËRGJEGJËSINË E: INTERSIG VIENNA INSURANCE GROUP

Ref	Përshkrimi i veprimt	Shuma debi	Shuma kredi
	Llog. e Arkëtueshme (klientë) Te Të ardhura Prime Takse Prime	18'375	16'705 1'670
	Banka Te Llog. e Arkëtueshme (klientë)	18'375	18'375

8.3 Kontabilizimi i shitjes së policës së sigurimit, kontabilizimi i blerjes së policës së sigurimit

Shitja e policës së sigurimit

Për shkak se shoqëritë e sigurimeve janë të përjashtuara nga TVSH për shitjen e primeve, në faturën tatimore nuk aplikohet TVSH. Për shitjet e tjera, përveç primeve, aplikohet TVSH sipas kërkesave të ligjit (psh shitja e një aseti). Kontabilizimet e shitjeve të tjera përveç primeve, është e njëjtë me çdo aktivitet tjetër.

Polica e sigurimit, dimë që, është produkti i shoqërive të sigurimit. Kur shoqëria e sigurimit shet një policë atëherë klienti që e blen ose ndryshe policëmbajtsi konsiderohet një e drejtë për shoqërinë e sigurimit. Pra nëpërmjet policës së sigurimit rregjistrohen të drejtat e shoqërisë për arkëtimin e primeve sipas policave të shitura. Në këtë rast llogaria Klientë(policëmbajtësi) do të debitohet dhe sipas rregullit për regjistrimin e dyfishtë do të kreditohen llogaritë Të ardhura nga primet e shkruara dhe llogaria Tatimi mbi primin (10%), dmth në qoftë se primi i policës së sigurimit është 20.000 lekë ,atëherë veprimi do të regjistrohej si më poshtë:

Ref	Përshkrimi i veprimit	Shuma debi	Shuma kredi
	Llog. e Arkëtueshme (klientë) Te Të ardhura nga Prime të shkruara Tatim mbi primin	20.000	18.000 2.000

Blerja e policës së sigurimit

Kontabilizimi i Blerjeve në shoqëritë e sigurimeve është përgjithësisht i njëjtë me shoqërite e tjera. Për shkak se shoqëritë e sigurimeve janë të përjashtuara nga TVSH, TVSH në blerje nuk rimburohet. Blerjet që lidhen me dëmet si psh faturat e blerjes nga serviset për riparimet e makinave të aksidentuara, nga firmat e ndërtimit për riparimet e objekteve të dëmtuara apo nga spitalet për shërbimet e mbuluara nga sigurimi i shëndetit, kontabilizohen përkatësisht tek Shpenzimet e Dëmeve sipas llojit të produktit. Në këtë rast bëhet kujdes për sistemin e Rezervës së Dëmeve për vlerën përkatëse. Në rastin e blerjes së policës së sigurimit kemi të bëjmë me një shpenzim për shoqërinë dhe pala së cilës i detyrohet shoqëria është furnitori. Pra furnitori përbën për shoqërinë një detyrim. Në këtë rast ne dimë që shpenzimet janë llogari që gjatë gjithë periudhës ushtrimore vetëm debitohen dhe në bazë të regjistrimit të dyfishtë ,por jo vetëm dhe për faktin që llogaria furnitorë për shtesa kreditohet, ky veprim do të regjistrohej si më poshtë :

Ref	Përshkrimi i veprimit	Shuma debi	Shuma kredi
	Shpenzim blerje për vlerën e primit të faturuar(përfshirë 10% tatimin mbi primin) Te Furnitorë (për blerje police	XXXXX	XXXXX

8.4 .Kontabilizimi i primeve të fituara dhe të pafituara në periudhën e ardhshme në shoqëritë e sigurimit.

Provizione për primin e pafituar dhe riskun e paskaduar.

Primi neto i shkruar mbulon një periudhë kohore të caktuar, e cila ndoshta mund të shtrihet gjatë periudhave të ndryshme kontabël. Për këtë qëllim primi neto i shkruar duhet të amortizohet gjatë gjithë periudhës kohore. Pjesa e cila aplikohet në një periudhë të caktuar kohore konsiderohet si primi i “fituar“ në këtë periudhë. Pjesa tjetër e primit, që i takon periudhës tjetër konsiderohet si primi i “ pafituar“. Prandaj primi neto i shkruar ndahet në prime të “fituara,, dhe prime të „pafitura,,. Shoqëria e vendos mënanë këtë prim të pafituar duke krijuar një shumë të parashikuar që quhet shuma e parashikuar si rezervë e primit të pafituar. Meqënëse këto prim-e janë për t’u aplikuar në muajt e ardhshëm, ato janë pjesë e të ardhurave në këta muaj. Kjo do të thotë që 1/12 e primit fitohet çdo muaj. Rezerva e primit të pafituar

llogaritet në bazë të proporcionalitetit. Nëse një prim për një vit në 1 shtator të 2018 do të figuronte 4/12 i fituar për 2018 dhe 8/12 i pafituar për 2018.8/12 do të figurojë i fituar në 2019. Një rritje në shumën e parashikuar si rezervë e primit të pafituar përbën një shpenzim të shoqërisë kur llogarit fitimet. Në kontabilitet provizioni për primin e pafituar do të bëhej me artikullin kontabël:

Ref	Përshkrimi i veprimit	Shuma debi	Shuma kredi
	Shpenzime provizioni për primin e pafituar	XXXX	
	Te Provizione për primin e pafituar		XXXX

Provizioni teknik i rrezikut të paskaduar

Një vlerësim i përgjegjesisë totale (duke përfshirë dhe shpenzimet) në lidhje me ekspozimin ndaj rrezikut, pas datës së mbylljes së vitit ushtrimor, për policat e lëshuara para asaj date, mund të tregojë që provizioni teknik i kërkuar është më i madh ose më i vogël sesa provizioni teknik i primit të pafituar. Në qoftë se provizioni teknik i kërkuar është më i madh se provizioni teknik i primit të pafituar, atëherë nevojitet një rezervë shtesë, e cila njihet si “provizioni teknik i rrezikut të paskaduar“. Në periudhat e ardhshme, primi i pafituar do të jetë e gjitha ajo shumë e cila është fituar për policat e trashëguara nga periudha e mëparshme kontabël. Kjo do të thotë që shuma e parashikuar si rezervë e primit të pafituar, është rezerva për kërkesat e ardhshme të siguracionit. Meqënëse shuma e parashikuar si rezervë e primit të pafituar shërben për pagimin e kërkesave të ardhshme, nuk është gjithmonë e pranueshme që një shoqëri, ta llogarisi këtë rezervë thjesht si një përqindje të primeve që merren. Nëse humbjet pritet të kalojnë atë përqindje të primeve të rezervës, atëherë rezerva duhet rritur respektivisht. Shuma shtesë në këtë rast quhet një shumë e parashikuar si rezervë për riskun e paskaduar. Provizioni teknik që duhet të mbahet për të përballuar dëmet e së ardhmes të cilat janë pasojë e rreziqeve të paskaduara, është e barabartë me:

Provizioni i teknik i riskut të paskaduar

(PRP) = primet e pafituara*raporti i pritur i dëmeve të pafituara

Rapori i pritur i dëmeve është i barabartë me:

Përgjegjësia totale për dëmet e ndodhuara në lidhje me primet e fituara

 Primet e fituara

Për të llogaritur raportin e mësipërm, duhet të merret në konsideratë një periudhë e caktuar kohe, duke përfshirë dhe vitin aktual. Në përgjegjësinë totale ku përfshihen gjithashtu edhe shpenzimet gjyqësore, të administrimit etj, merren parasysh dëmet e ndodhura në lidhje me primet e fituara për periudhën në konsideratë. Ndërsa primet e fituara, është një proporcion i primit total që mbulon rrezikun deri në datën e vlerësimit plus shpenzimet fillestare të lëshimit të policës dhe komisionin e agjentit ose ndërmjetësve të tjerë. Sa më e gjatë të merret në konsideratë periudha kohore, aq më e madhe është mundësia për të qënë sa më i saktë vlerësimi i raportit të mësipërm.

Tema 9: Të drejtat dhe detyrimet e konstatuara të periudhës

9.1. Përshkrimi ,koncepti i të drejtave edhe detyrimeve të konstatuara, kontabilizimi i tyre në shoqëritë e sigurimit

Me qëllim që të përmbushin objektivat e tyre, pasqyrat financiare të njëjësive ekonomike përgatiten mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Sipas kësaj metode, efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera njihen në pasqyrat financiare kur ato ndodhin (dhe jo kur paraja ose ekuivalentët e saj arkëtohen ose paguhen) dhe regjistrohen në kontabilitet e raportohen në pasqyrat financiare të periudhave kontabël, të cilave u përkasin. Pasqyrat financiare, të përgatitura në bazë të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, i informojnë përdoruesit jovetëm mbi transaksionet e shkuara të shoqëruara me arkëtime dhe pagesa, por edhe mbi detyrimet për t'u paguar në të ardhmen si dhe mbi aktive që do të sjellin arkëtime në të ardhmen. Në këtë mënyrë, ato paraqesin informacione mbi transaksionet dhe ngjarjet e shkuara të cilat u shërbejnë përdoruesve më së miri në marrjen e vendimeve ekonomike. Shpenzimet që lidhen me të ardhurat e fituara gjatë periudhës raportuese njihen në të njëjtën periudhë kontabël si dhe të ardhurat përkatëse. Shpenzimet e kryera gjatë një periudhe raportuese, që ndryshon nga periudha kur ato i sjellin përfitime njësisë ekonomike raportuese, regjistrohen si shpenzime pikërisht në periudhën kur merren përfitimet. Shpenzimet njihen në të njëjtën periudhë kontabël si dhe të ardhurat që lidhen me to. Nëse të ardhurat që lidhen me shpenzime të caktuara nuk mund të përcaktohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, atëherë për njohjen e tyre do të përdoren mënyra të tërthorta. Për shembull, shpenzimet që lidhen me blerjen e një mjeti afatgjatë material njihen si shpenzime gjatë jetës së dobishme të këtij aktivi (shpenzimet e amortizimit). Shpenzimet, që nuk priten të gjenerojnë të ardhura (përfitime), njihen si shpenzime në momentin kur ato ndodhin.

Shpenzimet e njësisë ekonomike i ndajmë në:

- shpenzime të parapaguara dhe
- shpenzime rritëse.

Kjo ndarje nuk sjell ndryshime në konceptimin e shpenzimit në vetvete por lidhet me momentin e njohjes dhe pagesës së tij. Grupi i parë i shpenzime përfaqëson shpenzime që më parë paguhen dhe më pas njihen në periudhën përkatëse. Ndërsa grupi i dytë ka të bëjë me shpenzime që më parë maturohen dhe më pas paguhet detyrimi për to.

Për të shpjeguar qartë çfarë përfaqësojnë shpenzimet e parapaguara le të shohim një shembull:

Më datë 01. 04. 2019 kompania X parapaguan siguracionin një vjeçar për njërin prej automjeteve të saj. Shuma e policës së sigurimit, përfshirë TVSH është 72. 000 lekë.

Lind pyetja: “A kemi të bëjmë me shpenzim?”. Përgjigja në parim është PO pasi ky shërbim që do të merret përfaqëson përfundimisht një fluks dalës të kompanisë X.

Problemi qëndron tek momenti i njohjes së tij. Meqenëse ky siguracion një vjeçar mbulon më shumë se një periudhë ushtrimore do të thotë se përfitimet prej tij ndahen në dyperiudha. Po në të njëjtën mënyrë duhet të shtrihen dhe shpenzimet që mundësojnë këtë përfitim. Shpërndarja bëhet në këtë rast mbi baza lineare, $\frac{3}{4}$ i takojnë periudhës aktuale (01.04. 2019) dhe $\frac{1}{4}$ i takon periudhës pasardhëse. Shohim konkretisht kontabilizimet:

Data	Përshkrimi	Debi	Kredi
01.04.2018	Shpenzime të parapaguara siguracioni TVSH te Banka	60. 000 12. 000	72. 000

31.12. 2018	Shpenzime sigurimi te Shpenzime të parapaguara	45. 000	45. 000
01.04. 2019	Shpenzime sigurimi Te Shpenzime të parapaguara	15. 000	15. 000

Siç e pamë dhe gjatë zgjidhjes së këtij ushtrimi, kishim të bënim me shpenzime që ishin parapaguar në një datë të fillimit por që nuk i përkisnin në vlerë të plotë periudhës kur ato ishin paguar. Pra, në një fjali të vetme mund të themi se shpenzimet e parapaguara (të shtyra) janë ato shpenzime që “paguhen sot dhe maturohen mot”. Praktikisht vlen të mbahet mend që shpenzimet e parapaguara lidhen vetëm me parapagime për shërbime dhe jo për parapagime blerje mallrash apo forma të tjera të aktiveve materiale dhe jo materiale. Blerja e aktiveve materiale dhe jo materiale nga njëra anë shton aktivet dhe nga ana tjetër shton detyrimet për furnitorin.

9.2. Kontabilizimi i primeve të pafituara, provizioneve specifike

Llogaria “Prime të pafituara” është një llogari rezervë që në momentin e vlerësimit përfaqson pjesën e sigurimeve të nënshkruara për të cilat policat e sigurimit është në fuqi, dmth se fondi nga primet mund të destinohet për të shlyer humbjet që mund të ndodhin ndërkohë deri në maturim apo në përfundim të policës. Rezerva për primet të pafituara është për të përballuar:

1. humbje të siguruar që duhen kompensuar nga shoqëritë e sigurimit
2. rimbursimin e mbajtësve të policave të cilët për arsye të ndryshme anullojnë kontratën e sigurimit
3. pagat në favor të një risiguruesi për policat e risiguruara.

Provizione të primit të pafituar vendoset në pasiv të bilancit, pra është një llogari e pasivit. Përlllogaritjet e Provizioneve të primit të pafituar i kryen aktuari pasi financa dhe çdo departament i ka dërguar të dhënat vjetore për primin, dëmet, marrëveshjet dhe kontratat e sigurimit, shpenzimet administrative. Në kontabilitet ky regjistrim do të kryhet me artikullin kontabël:

Ref	Përshkrimi i veprimit	Shuma debi	Shuma kredi
	Ndryshim i rezervës bruto të primeve (+/-) Te Rezerva teknike bruto për prime sipas produktit	xxxx	Xxxx

Përlllogaritjet e Provizioneve të dëmeve i kryen aktuari pasi financa dhe çdo departament i ka dërguar të dhëna vjetore për Primin, dëmet, marrëveshjet dhe kontratat e sigurimit si dhe shpenzimet administrative. Në kontabilitet ky regjistrim do të kryhet me artikullin kontabël:

Ref	Përshkrimi i veprimit	Shuma debi	Shuma kredi
	Ndryshim i rezervës bruto të dëmeve, RBNS(+/-) Te Rezerva bruto për dëme RBNS sipas produktit	xxxx	Xxxx

Pjesa e risiguruesve në provizionet teknike vendosen në Aktiv të bilancit, pra është një llogari aktive.

Përlllogaritjet e Provizioneve të primit të pafituar i kryen aktuari pasi financa dhe çdo departament i ka dërguar të dhëna vjetore për primin, dëmet , marrëveshjet dhe kontratat e sigurimit si dhe ,shpenzimet administrative.

Në kontabilitet ky regjistrim do të kryhet me artikullin kontabël:

Ref	Përshkrimi i veprimit	Shuma debi	Shuma kredi
	Ndryshim i rezervës bruto të primeve, pjesa për risigurime(+/-) Te Pjesa për bashkësigurime dhe risigurime e rezervës bruto për prime	xxxx	xxxx

Pjesa e risguesve në provizionet teknike vendosen në Aktiv të bilancit, pra, është një llogari aktive. Përlllogaritjet e Provizioneve të primit të dëmeve i kryen aktuari pasi financa dhe çdo departament i ka dërguar të dhëna vjetore për primin, dëmet, marrëveshjet dhe kontratat e sigurimit si dhe shpenzimet administrative. Në kontabilitet ky regjistrim do të kryhet me artikullin kontabël:

Ref	Përshkrimi i veprimit	Shuma debi	Shuma kredi
	Ndryshim i rezervës bruto të dëmeve pjesa për risigurime (+/-) Te Rezerva bruto për dëme pjesa për risgurime	xxxx	xxxx

Primi i shkruar është një prim i regjistruar në librat e një siguresi ose të një risiguresi në momentin që është lëshuar dhe paguar një policë. Primi për periudhën e ardhshme të ekspozimit quhet prim i pafituar për një policë individuale, prim i shkruar minus primin e pafituar është i barabartë me primin e fituar. Primi i fituar është e ardhur për periudhën kontabël, ndërsa primi pafituar do të jetë e ardhur në periudhën e ardhshme kontabël.

Primi neto i pafituar quhet rezervë e primit të pafituar .Primi i pafituar është i barabartë me: Primet e shkruara (neto e risigurimit dhe një fond për kostot e shpërndarjes) + rezervën e primit të pafituar në fillim të periudhës - Primin e pafituar në fund të periudhës.

Le ta ilustrojmë me një shembull:

Vlera e policës së sigurimit të blerë për periudhën 01 Prill 2018 deri në 30 Mars 2019 është 12.000 lekë.

Kontabilizimet për krijimin e rezervës së primit të pafituar do të ishin:

Ref	Përshkrimi i veprimit	Shuma debi	Shuma kredi
	Klientë Te Të ardhura	12. 000	12.000

Për lehtësi studimi me qëllim që të kuptohet thelbi i konceptit të primit të pafituar dhe duke u mbështetur në literaturën botërore, ka një mënyrë të thjeshtë.Kështu: periudha 01.04 2017 deri në 31.12 .2018 i përket vitit ushtrimor 2017,që do të thotë përfshin 9 muaj.Ndërsa periudha 01.01.2018 deri në 30.03 2018 përfshin 3 muaj dhe i përket vitit pasardhës.Në këto kushte themi se rezerva për primin e pafituar duhet të krijohet vetëm për tri muajt e vitit pasardhës. Sipas kësaj llogjike do të kryhen llogaritjet:

12.000: 12 muaj = 1000 lek x 3 muaj = 3000 lek

Pra vlera e rezervës për primin e pafituar është 3.000 lek

Kontabilizimet në fund të vitit, dmth në datë 31.12. 2017 do të bëheshin nëpërmjet artikullit kontabël:

Ref	Përshkrimi i veprimit	Shuma debi	Shuma kredi
	Shpenzim primi i pafituar	3. 000	
	Te		
	Rezerva për primin e pafituar		3.000

Në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve (PASH) këto zëra do të paraqiteshin përkatësisht: Shpenzime për primin e pafituar me tepricë debitore 3.000 lekë dhe të ardhura me tepricë kreditore 12.000 lekë.

Për vitin 2017 në llogaritë e bilancit është debituar llogaria: Klientë / banka për vlerën 12.000 lekë dhe është kredituar Llogaria: Rezerva për primin e pafituar për vitin 2018

Tema10: Rregullimi i marrëdhënieve me shtetin

10.1 Historiku i sigurimeve në botë dhe legjislacioni shqiptar

Historiku i Sigurimeve i ka fillesat e veta qysh nga bashkësitë e para njerëzore në kuadër të fiseve e më vonë edhe në familje. Rreziku i parë me të cilin njeriu është ballafaquar ka qenë uria, ndërsa masat përmes të cilave ka tentuar të mbrohet kanë qenë kontributet modeste obligative të grurit të individëve të cilët kanë dhuruar gjatë viteve të suksesshme të korrjeve. Historia e sigurimeve mund të përshkruhet duke e ndarë atë në shtatë etapa të evoluimit të cilat do t'i rendisnim si më poshtë:

- Periudha e parë mund të konsiderohet si parahistori e sigurimeve e cila shtrihet nga kohët e lashta deri në shekullin e 14-të.
- Periudha e dytë i përket periudhës nga shekulli i 14-të deri në fund të shekullit të 17 dhe kjo periudhë dëshmon lindjen e politikës së sigurimeve.
- Periudha e tretë përfshin shekullin e 18 dhe gjysmën e parë të shekullit të 19-të. Kjo periudhë e sheh zgjerimin e produkteve të sigurimeve dhe shfaqjen e kompanive të sigurimeve si një mënyrë më efektive për një nevojë në rritje për mbrojtje.
- Periudha e katërt fillon nga gjysma e dytë të shekullit të 19 deri në Luftën e Parë Botërore dhe nënvizon zhvillimin e menaxhimit profesional financiar, të grupeve të para të sigurimeve dhe fillimin e ndërhyrjes së qeverisë me programet e sigurimeve shoqërore.
- Periudha e pestë përfshin mesin e Luftës së Parë Botërore deri në Luftën e Dytë Botërore . Kjo periudhë është një epokë e bashkimit të biznesit .
- Periudha e gjashtë përfshin periudhën nga fundi i Luftës së Dytë Botërore deri në fund të shekullit 20. Konsiderohet si periudha e ndryshimeve të mëdha, revolucioneve dhe reformave në Botë.
- Periudha e shtatë nis me fillimin e shekullit të 21 dhe konkretisht me 11 shtatorin 2001 në SH.B.A., bashkë me katastrofat natyrore tragjike që çuan në rritjen e rolit të qeverisë për mbrojtjen kundër rreziqeve dhe pasigurive si terrorizmi dhe fatkeqësitë natyrore. Në mënyrë të përmbledhur themi se pasiguria e shekullit në format e saja të ndryshme vjen në fazën qendrore.

Sigurimet në Shqipëri kanë filluar mjaft vonë krahasuar me vendet e tjera të zhvilluara. Ato janë zhvilluar me karakteristikat dhe historikun e tyre. Doktrina shqiptare flet për ekzistencën e sigurimeve duke filluar nga periudha përpara Luftës së Dytë Botërore, atëherë kur në vitet

1930-1940 shoqëri të huaja sigurimi, kryesisht italiane, ndihmuan në krijimin e një tradite të mirë e mjaft të nevojshme për tregun e sigurimeve në Shqipëri. Fillimisht aktiviteti i tyre siguroes ishte përqëndruar në qytetet kryesore të vendit dhe përfshinte produkte si: sigurimi i ndërtesave, në industri, sigurimi i aksidenteve, i jetës dhe sigurimi nga fatkeqësi natyrore. Pas Luftes së Dytë Botërore, me vendosjen e rregjimit komunist qeveria shtetëzoi industrinë, bankat dhe të gjithë kapitalin tregtar në vend. Kjo ndikoi automatikisht edhe në të gjithë sistemin e sigurimeve duke reflektuar në këtë mënyrë politikat e qeverisë komuniste në strukturimin dhe ndërtimin e tij. Duke filluar nga viti 1948 deri në vitin 1965 në Shqipëri filluan të njiheshin forma të reja sigurimi. Gjatë kësaj periudhe në Shqipëri ekzistonte vetëm Instituti Shtetëror i Arkave të Kursimit dhe Sigurimeve, një institut i cili merrej me mbledhjen e kursimeve të qytetarëve, e atyre pak kursimeve që ata kishin, dhe sigurimin e kooperativave dhe ndërmarrjeve të eksport-importit. Me krijimin e parlamentit të parë pluralist, Shqipëria kaloi nga një ekonomi e centralizuar drejt një ekonomie të lirë tregu, ku mbizotëronte prona private dhe parimi i iniciativës së lirë ekonomike. Tregu i sigurimeve do të kthehej kështu në segmentin e parë të rëndësishëm të tregut financiar që u zhvillua më shpejt pasi Shqipëria hyri në modelin e ekonomisë së tregut të lirë në dekadën e fundit të shekullit të shkuar. Tregu i sigurimeve është tregu më i madh dhe më i avancuar i sektorit financiar jo-bankar. Kompanitë që operojnë në tregun e sigurimeve, së bashku me fondet e investimeve dhe fondet e pensioneve private janë nën mbikëqyrjen e drejtëpërdrejtë të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), dhe jo nga Banka Qëndrore. Gjatë viteve të fundit është krijuar një bazë juridike që rregullon të drejtat dhe detyrimet midis të siguruarit dhe shoqërisë siguroese, janë zgjeruar llojet dhe tipet e mbulimit të sigurimit, si dhe janë krijuar kushtet e mundësitë e risigurimit me shoqëritë e huaja por edhe vendase si mjet i domosdoshëm i mbrojtjes së interesave të të siguruarve.

10.2. Ligji për rregullimin e marrëdhënieve me shtetin në shoqëritë e sigurimit

Shoqëritë e sigurimeve ushtrojnë aktivitetin e tyre mbështetur në Ligjin Nr. 52/2014 për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit. Ky ligj rregullon krijimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit, me qëllim që tregu i sigurimeve të veprojë në një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe transparent, në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të konsumatorit. Shoqëritë e sigurimeve janë institucione të ndërmjetësimit financiar ose ndryshe skema të realizimit të mekanizmit që të kontribuojnë të gjithë për të dëmshpërblyer ndonjërin që e pëson. Aktiviteti i një shoqërie sigurimi është një raport tregtar i një entiteti të vetëm, të caktuar, me një numër të madh personash, fizikë dhe/ose juridikë. Në këtë vështrim shoqëria e sigurimeve është një subjekt i interesave publike për shkak të raportit që krijon me mjedisin dhe shoqërinë, edhe pse në pronësi mund të jetë private. Aktiviteti i një shoqërie sigurimi mund të ushtrohet nga një shoqëri e themeluar sipas ligjitt shqiptar, ose themeluar në një vend të huaj sipas ligjeve në atë vend, por që ushtron nëpërmjet një dega, ose filiali aktivitet edhe në Shqipëri. Për ta ushtruar këtë veprimtari ato duhet të liçensohen nga AMF (Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare) që është organi shtetëror i autorizuar për të kryer një veprimtari të tillë.

Procesi i liçencimit kalon në dy faza:

- Faza e miratimit paraprak
- Faza e liçencës përfundimtare.

Liçencat e lëshuara nga AMF janë të pakufizura në kohë, të patransferueshme dhe të patregtueshme.

10.3. Llogaritja e fitimi fiskal dhe derdhja e saj në shtet

Nocioni i rezultatit, mënyrat e përcaktimit dhe paraqitja e tij.

Rezultati i një njësie ekonomike mund të njihet me saktësi vetëm në mbarim të shfrytëzimit të saj, duke krahasuar shumën e të ardhurave të realizuara (përfshirë edhe ato nga shitja e elementëve të pasurisë së mbetur) me investimet e kryera që nga krijimi deri në likuidimin e njësisë ekonomike. Mirpo një rezultat i tillë nuk u përgjigjet kërkesave të drejtimit të njësisë ekonomike e as kërkesave të partnerëve të saj. Për këtë qëllim është pranuar që jeta e njësisë ekonomike të ndahet në periudha të cilat përpunohen si rregull me vitin kalendarik. Përcaktimi i rezultatit të njësisë ekonomike për një periudhë të dhënë ushtrimore bën të nevojshme zbatimin e disa konvencioneve apo marrëveshjeve të caktuara në mënyrë që ai rezultat t'i përafrohet në të mjaftueshme realitetit. Në themel të parimeve dhe rregullave të përcaktimit të rezultatit qëndron preokupimi për ruajtjen e kapitalit të njësisë ekonomike, si kusht bazë për jetesën, madje mbijetesën e saj në kushtet e një ekonomie konkurruese. Rregullat e vlerësimit, detyrimet ligjore për të mos përfshirë në rezultatin e ushtrimit plusvlerat e përcaktuara, për mosshpërndarjen e dividendëve fiktive etj, i përgjigjen këtij preokupimi.

Rezultati i ushtrimit mund të shprehet në dy mënyra:

1. Si diferencë midis të ardhurave dhe shpenzimeve të ushtrimit
2. Si ndryshim i shumës së kapitaleve të veta midis gjendjeve të tyre në mbyllje të ushtrimit dhe gjendjes në çelje të ushtrimit vjetor. Shpeshherë ndryshimi i kapitaleve të veta nuk është i barabartë me diferencën midis të ardhurave dhe shpenzimeve, për shkak se disa veprime regjistrohen drejtpërdrejtë në llogaritë e kapitaleve të veta pa u kaluar nëpërmjet llogarive të rezultatit siç janë:
 - Kontributet në kapital të marra gjatë ushtrimit
 - Shpërndarjet (tërheqjet ose kthimet) e kapitalit gjatë ushtrimit
 - Diferencat nga rivlerësimet
 - Ndryshime të tjera të rastit

Me qëllim që të analizohen kushtet dhe faktorët e formimit të rezultatit, ky përcaktohet si diferencë midis të ardhurave dhe shpenzimeve, të klasifikuara këto sipas natyrës ekonomike.

Tema 11: Veprimet e mbylljes dhe ndërtimi i pasqyrave financiare

11.1 Llogaritjet për përcaktimin e saktë të të ardhurave dhe shpenzimeve që i takojnë periudhës ushtrimore

Në shoqëritë e sigurimeve, si në çdo njësi ekonomike aktiviteti i biznesit është në funksion të qëllimit kryesor dhe ka të bëjë me realizimin e fitimit. Aktiviteti vlerësohet në fund të vitit ushtrimor dhe të gjitha veprimet, regjistrimet që kryhen në fund të kësaj periudhe për llogaritjen e rezultatit të shoqërisë dhe hartimin e pasqyrave financiare janë quajtur veprime të mbylljes. Veprimet e mbylljes për përcaktimin e rezultatit fillojnë me përcaktimin e shpenzimeve dhe të të ardhurave që shoqëria e sigurimit ka realizuar si dhe me regjistrimet kontabël të tyre. Pra, për të llogaritur rezultatin e një njësie ekonomike i referohemi të ardhurave dhe shpenzimeve që njësi ka patur gjatë një viti ushtrimor. Pikërisht diferenca midis të ardhurave të realizuara dhe shpenzimeve të bëra jep rezultatin e njësisë. Çdo e ardhur dhe çdo shpenzim llogaritet mbi bazë faturimesh mujore që kanë të bëjnë me: shpenzime për punonjësit, agjentët – komisione mujore mbi bazë të primit të policave të sigurimit, konsulentëve, ekspertëve të rivlerësimeve, shpenzimeve për pajisje kancelarie, për qira leasing, për udhëtime, dieta etj. Thamë që rezultati llogaritet si diferencë midis të ardhurave dhe shpenzimeve të periudhës ushtrimore. Të ardhurat

dhe shpenzimet e periudhës ushtrimore përbëjnë edhe kuotat –pjesë apo shumat të cilat në vitet paraardhëse kanë qenë regjistruar sit ë ardhura apo shpenzime të periudhave të ardhshme. Të ardhurave të realizuara gjatë ushtrimit dhe që i përkasin atij viti ushtrimor, u shtohen të ardhurat e lidhura normalisht në një ushtrim paraardhës por që për arsye gabimi apo harresenuk kanë qenë regjistruar në atë ushtrim. Po ashtu shpenzimeve të kryera gjatë periudhës ushtrimore dhe që i përkasin asaj periudhe u shtohen shpenzimet lidhura në një ushtrim paraardhës, por që për shkak gabimi apo harresenuk kanë qenë regjistruar në atë periudhë. Të ardhurat nga shitja e sendeve regjistrohen në kohën që shitësi i transferon blerësit rrisqet apo përfitimet e pronësisë, që përputhet si rregull me kohën e faturimit

Regjistrimet kontabël të sistemimit të llogarive, rregullimit dhe shpërndarjes periodike

Mbyllja e llogarive të gjendjeve

Kemi mësuar se llogaritë që përdoren në një njësi ekonomike klasifikohen në dy grupe të mëdha:

1. Në llogari të gjendjes
2. Në llogari të rezultatit.

Llogaritë e gjendjes janë ato llogari të cilat paraqesin gjendjet dhe lëvizjet e elementëve të pasurisë dhe të kapitalit në një moment të caktuar. Këto llogari mbyllen dhe dalin në bilanc me tepricat e tyre. Dimë gjithashtu që llogaritë që i përkasin elementëve pasurorë kanë teprica debitore dhe ato që i përkasin kapitalit kanë teprica kreditore. Efektet e veprimeve apo të ngjarjeve, të klasifikuara sipas kriterëve të caktuara metodologjike regjistrohen në llogaritë e librit të madh të parashikuara në planin e llogarive të shoqërisë. Regjistrimet e kryera në këtë mënyrë përbëjnë librin e madh. Në varësi nga format apo procedurat që zbatohen për mbajtjen e kontabilitetit, regjistrimi në llogaritë e librit të madh mund të jetë i njëkohshëm me regjistrimet kronologjike ose të kryhet në formën e mbartjes së shumave nga regjistrimet kronologjikenë llogaritë e librit të madh. Për çdo regjistrim në llogaritë e librit të madh duhet të tregohet data e kryerjes së regjistrimit dhe origjina e tij. Këto regjistrime ngurtësohen jo më rrallë se një herë në tre muaj. Shumat totale printohen dhe ruhen si dokumenta. Në kontabilitet përdoren disa llogari të posaçme për sistemimin e të ardhurave dhe shpenzimeve.

11.4. Hartimi i bilancit përfundimtar të periudhës në shoqëritë e sigurimit

Në shoqëritë e sigurimit si dhe në çdo njësi tjetër ekonomike në fund të një viti ushtrimor hartohet bilanci përfundimtar. Ky bilanc hartohet duke u bazuar në shifrat e bilancit verifikues të hartuar pas përmbledhjes së të ardhurave dhe shpenzimeve. Elementët e aktivitetit dhe elementët e pasivitetit paraqiten të grupuara sipas karakteristikave të tyre të përbashkëta. Nëpërmjet pasqyrës së bilancit bëhet i mundur evidentimi i gjendjes së çdo elementi si dhe analiza e veprimtarisë së shoqërisë së sigurimeve. Më poshtë po ndërtojmë një pasqyrë bilanci të plotë, por duke qenë se nuk i është referuar një situatë reale do të jepet pa vlera.

Bilanci i një shoqërie sigurimi

Nr	AKTIVI	Shuma		DETYRIMET +KAPITALI I VET	Shuma
A A/1	Aktive afatgjata Aktive jomateriale Emri i mirë		A	Kapitali dhe rezervat Kapitali Aksioner Rezerva të kapitali	

<p>A/2</p>	<p>Të tjera active afatgjata jomateriale Aktive afatgjata material Toka dhe ndërtesa Makineri ,pajisje,mjete transporti Të tjera aktive afatgjata material</p>		<p>Rezerva të krijuara nga fitimet Fitime/humbje të mbartura Fitim i periudhës</p>	
<p>A/3 A/3.1</p>	<p>Aktive afatgjata financiare Investime financiare të pronësisë Aksione dhe pjesëmarrje në degë Aksione dhe investime të tjera,të destinuara për shitje Aksione në shoqëritë e lidhura</p>		<p>B Provizione teknike dhe matematike Provizione për primin e pafituar Provizione për dëmet Provizione për bonuse dhe zbritje Provizione për barazim të dëmeve dhe të katastrofave Provizione të tjera teknike</p>	
<p>A/3.2</p>	<p>Investime financiare afatgjata të huadhënies Investime në obligacione të emetuara nga shoqëria e sigurimit Investime në obligacione të emetuara nga qeveritë Investime në obligacione të destinuara për shitje Hua tregtare afatgjata Hua hipotekare afatgjata</p>		<p>C Provizione teknike për policëmbajtësit e sigurimit të jetës D Provizione për risqe dhe detyrime të tjera Provizione për pensione Provizione të tjera E Depozita të risiguruesve F Detyrime të tjera tregtare Detyrime ndaj policëmbajtësve për dëmet Detyrimi ndaj ndërmjetësve Detyrime ndaj risiguruesve Huamarrje të ndryshme Huamarrje ndaj institucioneve kredidhënëse Detyrime ndaj punonjësve Detyrime ndaj shtetit Detyrime ndaj furnitorëve</p>	
<p>A/3.3 B C D</p>	<p>Investime afatgjata në tituj të tjerë financiarë Depozita afatgjatë Investime të tjera financiare Depozita në shoqërinë risiguruese Investime për llogari të policëmbajtësve të jetës Pjesa e risiguruesve në provizionet teknike dhe matematike</p>		<p>G Detyrimi tatimor i shtyrë H</p>	

	<p>Provizionet për primin e pafituar</p> <p>Provizionet matematike</p> <p>Provizionet për dëmet</p> <p>Provizione për bonuse dhe zbritje</p> <p>Provizione për barazim të dëmeve dhe të katastrofave</p>			<p>Shpenzime të llogaritura dhe të ardhura të konstatuara në avancë</p>	
E	<p>Pjesa e risiguruesve në provizionet teknike për policëmbajtësit e sigurimit të jetës</p> <p>Provizione për pensione</p> <p>Provizione të tjera</p>				
F	<p>Të drejta për arkëtim që lidhen me veprimtarinë siguruese</p> <p>Nga policëmbajtësit për primet (klientët)</p> <p>Nga ndërmjetësit për polecat e shitura</p> <p>Nga filialet e tjera</p> <p>Arkëtime të ndryshme</p>				
H	<p>Investime financiare afatshkurtra</p>				
I	<p>Parapagime dhe të ardhura të llogaritura</p>				
J	<p>Mjete monetare</p> <p>Arka</p> <p>Banka</p>			<p>TOTALI</p>	

	TOTALI				
--	---------------	--	--	--	--

Tema12: Vlerësimi i mbylljes vjetore

12.1. Kuptimi dhe rëndësia e vlerësimit të bilancit

Dimë që pasqyrat kryesore financiare janë mjetet të cilat kontabiliteti i shfrytëzon me qëllim të grumbullimit, përpunimit dhe prezentimit të informatave ekonomike. Për çdo njësi ekonomike pasqyrat financiare paraqesin të gjithë informacionin material që ndikon në gjendjen financiare, performancën financiare dhe fluksin e parasë së njësisë ekonomike raportuese. Një vend të rëndësishëm në tërësinë e pasqyrave financiare zë dhe bilanci kontabël i njësisë. Bilanci shpreh pozicionin financiar që ka një shoqëri sigurimi në një çast të dhënë, domethënë:

- çfarë dhe sa zotëron të mira nga të cilat realizohet ose pritet të realizohet një përfitim ekonomik;
- kujt dhe sa i detyrohet shoqëria e sigurimit në një moment të dhënë (detyrimet që janë borxhet e firmës ndaj të tretëve),
- diferencën zotërime minus detyrime ndaj të tretëve që është detyrimi kapital ndaj themeluesve, pronarëve apo aksionarëve të shoqërisë së sigurimit.

Bilanci i një shoqërie sigurimi dallon nga bilancet e firmave të tjera në zërat përbërës të tij që sintetizohen në pohimin se zotërimet kryesore të një shoqërie financiare janë të natyrës financiare dhe brenda tyre peshë më të lartë kanë ato likuide. Nga ana tjetër, detyrimet e një shoqërie sigurimi janë detyrime për rezerva të detyrueshme për mbulim humbjesh dhe shpenzimesh. Kur bëhet mbyllja vjetore e aktivitetit të shoqërisë është e domosdoshme të bëhet vlerësimi I gjendjes financiare të saj. Kjo për faktin sepse përcaktohet qartë nëse shoqëria është në gjendje të shlyejë detyrimet e saj, se si shoqëria ka financuar aktivitetin dhe si I ka përdorur burimet që ka pasur në zotërim .

12.2. Raporti i kërkesave, me primet në një shoqëri sigurimesh

Nga pikëpamja e shoqërisë së sigurimeve dhe e doktrinës së kontabilitetit, kërkesa shkaktohet kur ndodh një aksident apo një dëmtim. Raporti i kërkesavë ose siç njihet ndryshe raporti i humbjeve, është raporti që bën të mundur krahasimin e raportit të humbjeve të shoqërisë me raportin e primeve të shoqërisë. Ky raport shpeshherë keq-llogaritet dhe, për pasojë, çon në shumë konfuzion. Raportet e ulta të humbjeve zakonisht tregojnë se raportet janë llogaritur gabim ose normat e shpenzimeve janë te larta. Problemi shfaqet në përzgjedhjen që ka të bëjë me atë se cilat kërkesa (ose humbje) dhe prime të përdoren. Kontabiliteti duhet të reflektojë çfarë ka ndodhur në një periudhë të dhënë specifike në bazë të të drejtave të konstatuara; prandaj, ky raport përdor kërkesat e bëra ndaj primeve të fituara. Kërkesat e bëra janë ekuivalente me:

(Kërkesat e paguara gjatë periudhës) - (shumat e parashikuara si rezervë në fillim të periudhës) + (shumat e parashikuara si rezervë për kërkesat në fund të periudhës).

Primet e fituara të përdorura në këtë raport janë ato pjesë të primeve, të cilat do të alokoheshin për periudhën kohore nëfjalë. Ato janë ekuivalente me:

(Primet neto të shkruara) - (primin e pafituar në fund të periudhës) + (primin e pafituar në fillim të periudhës)

Çfarë përmase duhej të jetë raporti i humbjes?

Numri do të variojë, por diapazoni në tregjet efektivisht konkurruese zakonisht është 60% – 80%. Raporti i humbjes do të variojë sipas linjës së biznesit dhe, për pasojë, nga njëra kompani në tjetrën në vartësi të biznesit të saj mik.

Shembull:

Nëse kërkesat e bëra janë në masën **455 000 000**

Primet e fituara janë në masën **745 000 000**, atëherë përmasa e raportit të humbjes do të ishte:
 $455\,000\,000 / 745\,000\,000 \times 100\% = 61.07\%$

Përmasa e raportit të humbjes është edhe një funksion i shpenzimeve të kompanisë duke përfshirë komisionet e agjenteve. Sa më të larta të jenë shpenzimet, veçanërisht norma e komisionit, aq më i ulët pritet të jetë raporti i kërkesave.

12.3. Raporti i shpenzimeve me primet

Raporti i shpenzimeve është raporti që krahason shpenzimet e kompanisë me primet e kompanisë. Meqenëse kontabiliteti i shoqërisë së sigurimit fokusohet në aftësinë paguese, kompanitë i shlyejnë shpenzimet sapo ato të krijohen. Një pjesë mirë e shpenzimeve të një shoqërie sigurimesh janë të lidhura me shoqërinë si një shqetësim permanent. Nëse një shoqëri ndërpret regjistrimin e bizneseve, e gjitha ajo që nevojitet është caktimi i një stafi ose i një kontabilisti për të vazhduar likuidimin e kërkesave (kjo zakonisht edhe nënkontraktohet). Në këtë mënyrë shpenzimet e krijuara përbëjnë numëruesin e raportit, edhe nëse ato nuk janë të likuiduara. Shpenzimet që duhen përfshirë janë të gjitha ato që janë krijuar gjatë periudhës kohore, përveç shpenzimeve për investime të cilat merren kundrejt të ardhurave të investimeve dhe shpenzimeve të axhustimit të kërkesave të futura në shumat e parashikuara si rezervë të kërkesave. Për këtë arsye, shpenzimet që do të përfshihen në këtë raport janë komisionet, shpenzime zyre, taksat, etj. Primi i shkruar shërben si emërues sepse shumë prej shpenzimeve janë të lidhura me shitjen, nënshkrimin dhe krijimin e rekordeve për produktet e reja. Kështu që duke përdorur primin e shkruar realisht njihet se niveli i shpenzimeve është gjerësisht i diktuar nga ruajta e siguruesit si një shqetësim permanent.

Shembull:

Nëse shuma e shpenzimeve të kryera është **230 000 000**

Masa e primit është **745 000 000** atëherë raporti i shpenzimeve do të jete:

$230\,000\,000 / 745\,000\,000 \times 100 = 30.87\%$

Përmasa e pritshme e raportit të shpenzimit do të variojë edhe sipas linjës së produktit dhe sipas komisioneve. Një shifër e përafërt mund të ishte 30% deri në 40%, ku përafërsisht gjysma zakonisht ka të bëjë me shpenzimet e shpërndarjes.

12.4. Raporti i kombinuar në një shoqëri sigurimesh

Shuma e raportit të kërkesave me raportin e shpenzimeve është raporti i kombinuar. Për shembull, nëse ne kemi një raport humbje prej 70% dhe një raport shpenzimi prej 30%, atëherë raporti i kombinuar do të jetë 100%. Masa e pritshme e raportit të kombinuar do të variojë sipas linjës së produktit ashtu siç ndodh edhe me pjesët e tij përbërëse. Në rastin e një linje konkurrese produkti në një treg të avancuar sigurimesh, raporti do të jetë rreth 100%, dhe fitimi operativ i siguruesit do të jetë i barabartë me të ardhurën e investimit të fituar mbi asetet që mbulojnë rezervat teknike. Nuk është e pazakontë për një raport të kombinuar të shkojë mbi 100%. Industria e sigurimit të përgjithshëm kalon nëpër cikle në të cilat konkurrenca i detyron shoqëritë të ulin primet nëpërpjekje për të fituar një pjesë më të madhe tregu. Primet e ulta shkaktojnë rritjen e raporteve të kombinuara dhe gjithsecili humbet para dhe primet ecin mbrapsht.

Nëse marrim në konsideratë vlerat e raporteve të kërkimit dhe të shpenzimit të llogaritura në çështjet përkatëse atëherë raporti i kombinuar do të ishte:

$$(455\,000\,000 / 745\,000\,000 \times 100\%) + (230\,000\,000 / 745\,000\,000 \times 100) = 61.07\% + 30.87\% \\ = 91.94\%$$

Pra raporti i kombinuar = 91.94 %

Përfitueshmëria e Kompanisë

Kompanitë e sigurimit të përgjithshëm paraqesin pasqyrat e tyre të fitimit dhe të humbjes duke llogaritur së pari të ardhurat e nënshkruara dhe pastaj duke i shtuar asaj të ardhurën e investimit për të arritur tek fitimi apo humbja në total. E ardhura e nënshkruar është fitimi i lidhur drejtpërsëdrejti me policat e sigurimit ose fitimi i nxjerrë nga nënshkrimi ose prezumimi i riskut. Ky fitim llogaritet duke marrë primet e fituar dhe duke zbritur kërkesat e bëra dhe të gjitha shpenzimet e përfshira në raportin e shpenzimit. E ardhura e investimit është një e ardhur e fituar nga investimet pasi zbriten të gjitha shpenzimet e investimit. Kështu mund të themi se e ardhura e investimit që vjen nga qarkullimet e kesh-it të gjeneruara nga aktiviteti i sigurimit duhen ndarë nga e ardhura e investimit mbi asetet e financuara nga fondet e aksionerëve, në mënyrë që fitimi i vërtetë operativ të mund të përlllogaritet. Fitimi në total përbëhet nga fitimet e nënshkruara plus të gjitha të ardhurat e investimit. Shembull:

Në qoftëse fitimi teknik (nga aktiviteti i sigurimeve) është 69 300 000

Fitimi JoTeknik (nga aktiviteti i investimeve) është 11 200 000 atëherë

Fitimi total është: 69 300 000 + 11 200 000 = 80 500 000